



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

RAPORT MBI GJENDJEN NË ZBATIMIN E MARRËVESHJEVE TË BRUKSELIT

Mars - Shtator 2015

**RAPORT I DORËZUAR TEK BASHKIMI EVROPIAN / SHËRBIMI
EVROPIAN PËR VEPRIM TË JASHTËM**

NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, 6 tetor 2015

Ky raport periodik i prezantuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës jep një vlerësim mbi gjendjen aktuale në Dialogun e Brukselit në gjashtë muajt e fundit nga marsi deri në shtator të vitit 2015.

Në përgjithësi, Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron që dialogu i Brukselit ka shënuar progres shumë të mirë gjatë kësaj periudhë raportuese sepse ka pasur një sërë marrëveshjesh të arritura rreth temave të rëndësishme dhe ka pasur progres në zbatimin e disa prej tyre.

Natyrisht, përfundimi i periudhave zgjedhore në të dy shtetet, në Kosovë dhe Serbi, si dhe emërimi i radhës i PLBE-së, krijuan një momentum të ri për një vazhdim më energjik dhe të freskët të dialogut. Janë mbajtur takime intensive në nivelin politik ndërmjet Kryeministrave të të dy shteteve si dhe në nivel teknik.

Raporti vë në dukje progresin dhe sfidat në dialogun e Brukselit gjatë periudhës raportuese si dhe shqyrton çështjet e mbetura përdërisa prezanton idetë dhe rekomandimet për zgjidhje.

Marrëveshjet e arritura përfshijnë temat siç janë: drejtësia, shuarja e mbrojtjes civile, asociacioni, largimi i barrikadës nga ura e Mitrovicës dhe sigurimi i automjeteve. Po ashtu janë arritur dy marrëveshje të rëndësishme për energjinë dhe telekomunikacionin, me të cilat zhbllkohet procesi në mënyrë që të vazhdohet progresi në drejtim të zbatimit të marrëveshjeve përkatëse të vitit 2013. Tema e vetme dhe më e rëndësishme që mbetet për tu dakorduar në këtë fazë të dytë të dialogut është largimi i strukturave paralele të Serbisë në Kosovë.

Të gjeturat e këtij raporti tregojnë progres të mirë në fusha të ndryshme duke përfshirë, drejtësinë, shuarjen e mbrojtjes civile, sigurimi i automjeteve, ndërsa, në fushat tjera progresi duket i kufizuar. Marrëveshja në pako e arritur më 25 Gusht 2015 për energjinë, telekomunikacionin/kodin telefonik të Kosovës, asociacionin dhe largimin e barrikadës, janë në fazën fillestare të zbatimit.

Procesi i zbatimit ka vazhduar të përballet me sfida dhe paradokse që pengojnë zbatimin efektiv dhe real të marrëveshjeve. Dua të theksoj këtu paradoksin kryesor që vjen nga qasja e dyshimtë e Serbisë ndaj dialogut. Kjo për shkak se Serbia në njërin anë punon për zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit e në anën tjetër vazhdon të përkrahë strukturat e saja paralele ilegale në Kosovë. Kjo qasje e dëmshme e Serbisë ka shpjer në situatë paradoksale ku strukturat legale dhe ato ilegale funksionojnë në pjesën veriore të Kosovës dhe përtej. Prandaj, përdërisa Serbia paraqitet tek BE-ja si palë e cila i respekton marrëveshjet e Brukselit, në terren megjithatë vazhdon me ndërhyrje në Kosovë.

Qeveria e Kosovës i ka raportuar BE-së për paradokset e lartpërmendura, dhe e ka bërë të qartë që themelimi i asociacionit mund të ndodhë vetëm atëherë kur të gjitha strukturat paralele të Serbisë në Kosovo të shuhen tërësisht. BE-ja i është përgjigjur pozitivisht kësaj kërkesë, prandaj një Grup Punues trepalësh do të mblidhet në Bruksel për të zgjidhur këtë çështje. Puna në hartimin e statutit të asociacionit si dhe puna në shuarjen e strukturave paralele do të jetë i njëkohshëm.

Qeveria e Kosovës dëshiron të theksoj se zbatimi i marrëveshjeve është kyç për sukses të plotë të këtij dialogu dhe krijon argument për vazhdimin e tij. Ne konsiderojmë që zbatimi i plotë dhe i vërtetë i marrëveshjeve të Brukselit, pa standarde të dyfishtë, mund të sjellë progres të vërtetë këtij dialogu. Besojmë që konsistenca dhe përkushtimi duhet të mbahen, për të pasur më shumë progres në këtë proces të rëndësishëm paqësor dhe të marrëdhënieve të mira fqinjësore që ndihmon të dy shtetet të afrohen më BE-në, si dhe përforcon paqen dhe stabilitetin në rajon.

Qeveria e Kosovës mbetet plotësisht e përkushtuar ndaj dialogut të Brukselit për shkak të rëndësisë së tij në shumë nivele, në normalizimin e gjendjes në veriun e Kosovës, në përshpejtimin e integritetit të plotë të komunitetit Serb në sistemin e Kosovës si dhe në normalizimin e marrëdhënieve bilaterale ndërmjet dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë. Në kuadër të procesit të integritetit në BE, ky dialog kontribuon në marrëdhënie të mira fqinjësore dhe në stabilitetin rajonal, që të dyja kritere të rëndësishme për anëtarësim në BE për të dy shtetet, Kosovës dhe Serbisë.

Qeveria e Kosovës ka demonstruar një përkushtim të qartë dhe aktiv në dialogun e Brukselit dhe në zbatimin efektiv të marrëveshjeve. Republika e Kosovës po ashtu ka bërë progres të konsiderueshëm dhe të matshëm në reformat evropiane dhe Euro-Atlantike. Prandaj, ne presim progres konkret dhe të merituar për Kosovën në procesin e integritetit në BE. Kosova pret nga BE që përfundimisht të merr vendimin për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) me Kosovën si dhe për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, sa më shpejtë që të jetë e mundur.

Qeveria e Kosovës çmon lartë rolin e Bashkimit Evropian e posaçërisht të Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm në lehtësimin e dialogut si dhe mbështetjen e plotë dhe aktive nga SHBA-të për këtë dialog së bashku me mbështetjen në rritje nga Gjermania dhe nga shtetet tjera të BE-së.



Edita Tahiri

Ministre për Dialog

Kryenegociatore në Dialogun Teknik të Brukselit

Parathënie	2
Përmbajtja	4
Përmbledhja ekzekutive	5
1. Vazhdon funksionimi i brishtë i komunave veriore	9
2. Strukturat paralele të Serbisë në Kosovë - ende nuk janë larguar	11
3. Shpërbërja e 'Mbrojtjes Civile'	13
4. Drejtësia	17
5. Largimi i barrikadës në Urën e Mitrovicës	22
6. Asociacioni	22
7. Telekomunikacioni	25
8. Energjia	27
9. IBM - Objektet e përhershme dhe çështjet tjera	30
10. Sigurimi i automjeteve	33
11. Përfaqësimi dhe bashkëpunimi rajonal	34
12. Zyrat ndërlidhëse	36
13. Mbledhja e të hyrave doganore	37
14. Certifikatat e produkteve farmaceutike (CPF)	38
15. Fondi për zhvillim	40
16. Liria e lëvizjes	41
17. Tregtia e lirë	44
18. Kadastri	45
19. Diplomat	47
Lista e shkurtesave	49

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky raport i Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi gjendjen në zbatim në dialogun e Bruksel i prezantohet BE-së në baza të rregullta me qëllim të avancimit të cilësisë dhe efektivitetit të këtij procesi. Raporti përfshinë periudhën mars-shtator 2015.

Raporti analizon progresin dhe sfidat e Dialogut të Bruksel në gjashtë muajt e fundit, duke u përqendruar në procesin e zbatimit në përgjithësi si dhe në secilën marrëveshje në veçanti, duke vënë në pah çështjet e pazgjidhura dhe faktorët që ndikuan në rezultate të tilla.

Progresi matet në bazë të marrëveshjeve të arritura, zbatimit efektiv të marrëveshjeve si dhe zbatimit që është në vazhdim e sipër. Vlerësimi i progresit është grupuar në tri nivele: progresi i mirë i referohet marrëveshjeve të arritura dhe të zbatuara apo që janë në rrugë të mirë të zbatimit, pak progres i referohet marrëveshjeve të arritura që presin zbatimin, dhe pa progres i referohet situatave pa marrëveshje mbi temat të cilat tashmë janë në agjende të dialogut.

Duke shikuar faktorët që sipas të gjitha gjasave kanë pasur ndikim në rezultate, tri prej tyre konsiderohen si më relevante. E para, rritja e dinamikës së dialogut prej që PLBE-ja Federica Mogherini e mori detyrën. E dyta, përkushtimi i qartë dhe aktiv i Kosovës për të bërë progres në këtë dialog. Dhe e treta është qasja e dyshimtë e Serbisë në dialog përmes angazhimit në marrëveshje por me mungesë vullneti për t'i ndaluar ndërhyrjet në Kosovë, të demonstruar përmes përforsimit të strukturave të saja paralele në Kosovë.

Bazuar në zhvillimet në terren, gjendja aktuale në dialogun e Brukselit është si vijon:

PROGRES I MIRË ËSHTË ARRITUR NË:

Drejtësi - zbatimi i Marrëveshjes për drejtësi e arritur më 10 Shkurt 2015 ka shënuar progres të rëndësishëm në vendosjen e sistemit unik të drejtësisë në pjesën veriore të Kosovës si dhe në integrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serb në institucionet e drejtësisë të Kosovës. Mbeten edhe disa çështje për tu zgjidhur.

Shpërbërja e "Mbrojtjes Civile" - marrëveshja për shpërbërjen e "Mbrojtjes Civile" (MC) është arritur më 26 prill 2015 pas pothuaj se dy viteve të negociatave. Procesi i zbatimit ka shënuar progres substancial, që shpejt pritet të finalizohet. Shpërbërja e "MC"-së pothuajse është përmbyllur përveç dorëzimit të objekteve tek institucionet e Kosovës. Integrimi i ish-anëtarëve të "MC"-së është përmbyllur mbi 90% (nga totali i 383 personave), paneli i rekrutimit po punon për përfundimin e këtij procesi.

Energji – marrëveshja për energjinë/konkluzionet e dakorduara, e arritur më 25 Gusht 2015 ndihmoi zhbllokimin për të rihapur rrugë procesit të zbatimit. Si rezultat Kosova/KOSTT nënshkroi marrëveshjen për lidhje me ENTSO-E dhe me anëtarët e saj, sepse Serbia u detyrua ta tërheq ankesën e parashtruar kundër Kosovës, në pajtim me marrëveshjen për energji të vitit 2013. Procesi i regjistrimit të dy kompanive reja, njëres për tregti të energjisë dhe tjetrës për furnizim dhe shërbime distribuive, do të përfundoj menjëherë nga Agjencioni Kosovar për Regjistrim të Biznesit, posa këto kompani të korrigjojnë aplikacionin në përputhje me legjislacionin e Kosovës siç parashihet me marrëveshjen për energji.

Marrëveshja për sigurim të automjeteve – më në fund është arritur më 23 qershor të vitit 2015 dhe zbatimi filloi më 12 Gusht 2015. Kjo marrëveshje mundësoi njohje reciproke të polisave të sigurimit të automjeteve midis dy shteteve, dhe është duke u zbatuar në nivel të kënaqshëm.

PAK PROGRES ËSHTË BËRË NË:

Kodin telefonik për Kosovën – marrëveshja është arritur më 25 gusht 2015 duke hapur rrugë për zbatimin e marrëveshjes së vitit 2013 për Telekomunikacionin, që Kosovës t'i jepet kodi telefonik 383 nga ITU. Në mënyrën korrespoduese, Kosova do të zbaton një autorizim të përkohshëm të shtrirjes së kufizuar të aktiviteteve të telefonisë mobile për një kompanie të re, një degë të një kompanie serbe, të regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës. Duke pasur parasysh që afati për këta hapa është 15 janari i vitit 2016, zbatimi efektiv mbetet të vlerësohet.

Asociacioni – marrëveshja për parimet kryesore të themelimit të Asociacionit të komunave me shumicë Serbe në Kosovë është arritur më 25 gusht 2015. Asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk do të jetë një nivel tretë i qeverisjes në Kosovë. Roli i tij do të jetë të ndihmoj komunat anëtare si dhe të ndihmoj integrimin e komunitetit serb në sistemin e Kosovës. Procesi i zbatimit përfshinë disa hapa përfshirë hartimin e statutit të Asociacionit. Kosova pohon që themelimi i këtij asociacionit kërkon krijimin e kushteve të duhura, që nënkupton shpërbërjen e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë.

Largimi i barrikadës në Urën e Mitrovicës – marrëveshja është arritur në vitin 2015, në përkrahje të marrëveshjes së arritur vitin e kaluar. Barrikada do të largohet më 15 tetor 2015, përmes revitalizimit të urës, që do të realizohet nga BE-ja. Marrëveshja po ashtu adreson çështjen e ndërtimeve ilegale të natyrës politike nga Serbia përmes mbështetjes së Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Kosovës për Planifikimin Urban (MMPH) dhe kryetarëve të të dy komunave të Mitrovicës mbi Planin Zhvillimor

Komunal, në përputhje me vijat kufizuese administrative të zonave kadastrale të dy komunave, siç përcaktohet me ligjet e Republikës së Kosovës.

MIK Pikë-kalimet e përhershme kufitare – është shënuar progres në kuptim të financimit nga ana e BE-së, edhe pse ende nuk është nënshkruar kontrata me partnerin implementues për ndërtim. Qeveria e Kosovës ka marrë të gjitha vendimet e nevojshme për çështjen e shpronësimit, për tre PKK-të e MIK-ut ku Kosova është palë nikoqire.

Zyrat Ndërlidhëse – është arritur progres në çështjen e administrimit të vizitave të ndërsjella zyrtare (fillimisht ishte bërë nga delegacioni i BE-së në të dy vendet). Çështjet e mbetura përfshijnë mungesën e progresit në takimet e nivelit të lartë të zyrtarëve ndërlidhës të Kosovës me zyrtarët Serb, përderisa Kosova ka qene bashkëpunuese në këtë çështje. Po ashtu, çështja e vulave dhe e logove që do të përdoren është në pritje.

Marrëveshja për bashkëpunim dhe përfaqësim rajonal – është arritur progres i rëndësishëm në anëtarësimin e Kosovës në organizatat dhe iniciativat rajonale. Megjithatë, Serbia vazhdon të shkelë këtë marrëveshje duke i vënë pengesa Kosovës, për çka BE-ja duhet të angazhohet për të gjetur rrugëdalje; shembulli i fundit është rasti i KOSTT – ENTSO-E me ç’rast Serbia u desh të tërheq ankesën e saj pas presioneve të BE-së.

NUK KA PASUR PROGRES NË:

Shpërbërjen e të gjitha strukturave paralele të Serbisë në Kosovë – deri më tani nuk ka pasur progres në këtë çështje. Sipas marrëveshjes në Bruksel, grupi punues trepalësh duhet të mblidhet për të filluar bisedimet rreth kësaj çështje, dhe zbatimi i saj duhet të përfundoj para themelimit të Asociacionit.

PARADOKSET TË CILAT PENGOJNË ZBATIMIN EFEKTIV

Gjatë kësaj periudhë raportuese, kanë vazhduar zhvillimet negative të shkaktuara nga ana e Serbisë. Në mënyrë paradoksale, Serbia në njërin anë punon në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit e në anën tjetër vazhdon të mbështes strukturat e veta ilegale paralele në Kosovë. Kjo qasje e dëmshme e Serbisë ka shpjer në situatën paradoksale ku strukturat legale edhe ato ilegale funksionojnë në pjesën veriore të Kosovës dhe përtej. Paradokset shihen më qartë në faktin që strukturat komunale legale dhe ato ilegale paralelisht funksionojnë në katër komunat veriore, edhe pse ky fenomen është i përhapur në tërë Kosovën. Sipas marrëveshjes së arritur në Bruksel, katër komunat veriore në Kosovë kanë marr pjesë në zgjedhjet lokale në Kosovë në vitin 2013, megjithatë deri më tani funksionimin i tyre legal është i brishtë dhe larg nga të qenit tërësisht funksional.

Kjo, për shkak së strukturat komunale ilegale të Serbisë në Kosovë kanë vazhduar të operojnë duke penguar punën e komunave legale. Përderisa Serbia është pajtuar të respektoj marrëveshjen në njërin anë, ajo në anën tjetër ka vazhduar të mbështes kryetarët ilegal dhe strukturat ilegale. Për shembull pas inaugurimit të kryetarëve dhe të kuvendeve të zgjedhura komunale, Serbia ka emëruar disa nga personat e njëjtë si kryetar të organeve ilegale komunale (kryetarët e Leposaviqit dhe të Zubin Potokut janë në të njëjtën kohë kryetar legal dhe ilegal), përderisa kryetari ilegal i Mitrovicës veriore është njëherësh nënkryetar legal i kësaj komune. Kjo situatë paradoksale mbizotëron në mbarë Kosovën. Së këndejmi, gjersa Serbia e paraqet veten para BE-së si një palë e cila i respekton marrëveshjet e Brukselit, në terren ajo vazhdon me ndërhyrje në Kosovë.

Gjendja në zbatim në të gjitha çështjet e trajtuara në dialogun në Bruksel, është paraqitur në hollësi në vijim.

1. FUNKSIONIMI I BRISHTË I KATËR KOMUNAVE VERIORE NË KOSOVË – PËR SHKAK TË NDËRHYRJEVE NGA SERBIA

Ka vazhduar edhe gjatë periudhës raportuese brishtësia e funksionimit ligjor të katër komunave veriore në Kosovë. Pothuajse dy vite pas zgjedhjeve lokale, në komunat veriore, Mitrovicë e veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan ende ka vështirësi për të zbatuar ligjet dhe standardet e Republikës së Kosovës. Përderisa bashkëpunimi në nivel politik ndërmjet kryetarëve të atyre komunave dhe Qeverisë së Kosovës është përmirësuar, kjo nuk përkon me gjendjen në terren në kuptim të zbatimit të plotë të legjislacionit të Kosovës.

Siç raportohet nga institucionet përkatëse, vështirësitë përfshijnë: mungesën e progresit në funksionimin dhe punën e autoriteteve legale komunale për shkak të pengesave nga strukturat paralele, problemet me procesimin e pagave të stafit komunal, dështimit të autoriteteve komunale për të iu ofruar qytetarëve shërbime, siç është përcaktuar në legjislacionin e Kosovës, paraqitja e problemeve në planifikim të buxhetit, çështja e simboleve zyrtare ligjore mbetet e pazgjidhur, regjistrimi i popullatës për ato komuna (pasi që refuzuan regjistrimin e popullsisë në vitin 2011) është në përgatitje e sipër në rast se nuk do të paraqiten pengesa.

Funksionimi i autoriteteve legale komunale i penguar nga Serbia

Arsyeja kryesore e mungesës së progresit në funksionalizimin dhe punën e autoriteteve legale komunale janë pengesat e vazhdueshme në punën e tyre nga ndërhyrjet paralele të Serbisë. Kjo situatë paradoksale ku strukturat komunale legale dhe ilegale operojnë njëkohësisht, normalisht që nuk ka mundur të krijoj progres në funksionimin ligjor të komunave. Serbia vazhdon të mbështes strukturat ilegale paralele në mënyrë politike dhe financiare, prandaj pushteti joformal i kryetareve ilegal pengon në masë të madhe punën e strukturave legale komunale. Në fakt fenomeni i strukturave paralele të Serbisë shtrihet në tërë Kosovën. Edhe pse Serbia pohon se respekton marrëveshjet e Brukselit rreth kësaj çështje, menjëherë pasi janë zgjedhur strukturat legale komunale në zgjedhjet e Kosovës në vitin 2013, Serbia i ka përtërirë emërimet e strukturave paralele, kryesisht ka emëruar shefat dhe zyrtarët e të ashtuquajturave ‘trupat e përkohshme komunale’. Për më tepër informata rreth kësaj çështje shihni seksionin vijues të këtij raporti.

Autoritetet komunale në masë të madhe kanë dështuar t’ju ofrojnë shërbime qytetarëve

Për shkak të ndërhyrjeve dhe paralelizmit që vjen nga Serbia, katër komunat veriore kanë dështuar t’iu ofrojnë shërbime qytetarëve siç parashihet me ligjet e Kosovës, në

mënyrë specifike, për ofrimin e shërbimeve në 28 fushat e kompetencave të veta dhe në 4 të deleguara dhe 2 kompetencave të zgjeruara. Në vend të tyre, shërbimet në mënyrë ilegale ofrohen nga strukturat ilegale komunale. Kosova në mënyrë të rregullt i ka raportuar BE-së rreth këtyre problemeve.

Sërish probleme me planifikimin e buxhetit

Është për të ardhur keq që planifikimi buxhetor do të jetë një problem edhe për vitin e ardhshëm si dhe miratimi i buxheteve legale komunale për vitin 2016 nga katër komunat veriore do të përballet me të njëjtat vështirësi. Problemi është i natyrës politike dhe ka të bëjë me ndërhyrjen e Serbisë në këto katër komuna duke i penguar ato të pranojnë buxhetimin e Kosovës në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë. (Përderisa gjashtë komunat tjera me shumicë Serbe në Kosovë e kanë pranuar tërë buxhetin).

Çështja e pazgjidhur e simboleve zyrtare legale

Katër komunat veriore ende operojnë pa simbole zyrtare legale dhe nganjëherë madje përdorin edhe simbolet e paligjshme. Simbolet e ligjshme zyrtare të komunave, d.m.th. logot, vulat dhe flamujt ende janë të pazgjidhura, kryetarët vazhdojnë të refuzojnë përdorimin e emblemës së Kosovës në dokumentet e tyre zyrtare dhe në vend të kësaj për komunikim me institucionet qendrore përdorin letra të zbrazëta.

Regjistrimi i popullsisë pritet të realizohet

Regjistrimi i popullsisë që do të mbahet në katër komunat veriore është një tjetër hap i rëndësishëm në përmirësimin e qeverisjes lokale demokratike, përveç nëse nuk paraqitet ndonjë pengesë. Në fillim të vitit 2014, gjatë bisedimeve të mbajtura ndërmjet atëherë Zëvendës Kryeministres Edita Tahiri dhe të kryetarëve të zgjedhur të këtyre komunave, në prezencë të zyrës së BE-se dhe Ambasadës Amerikane në Kosovë, është arritur pajtimi që të behet regjistrimi i popullsisë duke pasur parasysh që ato komuna patën refuzuar të marrin pjesë në regjistrimin e vitit 2011. Që nga ajo kohë, institucionet gjegjëse të Kosovës në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar kanë punuar për të përgatitur procesin ligjor dhe teknik për regjistrim. Më 22 shtator të vitit 2015, BE-ja informoi Qeverinë e Kosovës se kanë vendosë të mbështesin projektin e Regjistrimit të Popullsisë në katër komunat veriore të Kosovë të cilat nuk patën marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë së vitit 2011. Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës ka përgatitur projektligjin për këtë regjistrim të pjesshëm dhe pritet janë që deri në fund të këtij viti të miratohet në procedurë të përshpejtuar nga Kuvendi i Kosovës. Regjistrimi do t'i ndihmojë komunat dhe Qeverinë e Kosovës në planifikim të avancuar. Informatat e besueshme, të sakta dhe të detajuara mbi popullsinë në komunat veriore të Kosovës do të mundësojnë alokimin e saktë të fondeve

nga granti i përgjithshëm i Buxhetit të Kosovës për komunat, e po ashtu edhe grante specifike për arsim dhe shëndetësi si dhe për një numër të punësuarve në administratë dhe në këta sektorë. Regjistrimi po ashtu përfundimisht do të përcaktoj edhe numrin e ulëseve në Kuvendet Komunale.

2. STRUKTURAT PARALELE TË SERBISË NË KOSOVË – ENDE NUK JANË LARGUAR

Serbia vazhdon me ndërhyrje në Kosovë përmes mbështetjes së strukturave paralele, në kundërshtim me Marrëveshjen e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore mes dy shteteve. Strukturat paralele të Serbisë në Kosovë janë pengesat kryesore në procesin e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit. Siç raportohet, këto struktura veprojnë ilegalisht në tërë Kosovën, edhe pse në mënyrë më agresive në pjesën veriore të Kosovës. Prandaj, shpërbërja e tyre është vendimtare për zbatimin efektiv të marrëveshjeve dhe për normalizimin e situatës në pjesën veriore të Kosovës.

Sipas dëshmimeve tona, kryetarët ilegalë janë ata që marrin mbështetje politike dhe pagesa nga Serbia dhe me pushtetin e tyre joformal në masë të madhe pengojnë punën e kryetarëve/organeve komunale të zgjedhura në mënyrë demokratike si dhe punën e tyre në përputhje me ligjet e Kosovës.

Strukturat paralele ilegale të Serbisë veprojnë në mbarë Kosovën. Disa prej tyre janë larguar ose janë duke u larguar pas zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit, edhe pse shumica e tyre ende veprojnë, pavarësisht marrëveshjeve. Ne nuk kemi qenë në gjendje për të gjetur prova të hollësishme. Më poshtë janë disa nga të dhënat të cilat ne i posedojmë:

Strukturat paralele komunale dhe personat e emëruar janë: për Komunën e Mitrovicës Veriore, Aleksandër Spiriç u emërua si kryetar i të ashtuquajturit "organit të përkohshëm të kuvendit komunal të Mitrovicës së Kosovës" (ai është edhe zëvendës kryetar legal i Komunës së Mitrovicës së Veriut, i emëruar nga Kryetari i zgjedhur ligjërisht Dragan Rakiq). Gjithashtu, janë emëruar edhe anëtarët e këtij organi, përkatësisht Dragisha Vlashkoviç, Dragan Radisavljeviç, dhe Ninislav Gjeriç. Për komunën e Zveçanit, kryetar ilegal i këtij organi është emëruar Vuçina Jankoviç (ai është edhe kryetar i komunës së Zveçanit, i zgjedhur ligjërisht në zgjedhjet lokale të Kosovës në nëntor të vitit 2013). Anëtarët e këtij organi janë: Dragan Nedelkoviç, Ivan Todosijević, Sinisha Milosavljeviç, Milivoje Galjak dhe Miodrag Aciç. Për komunën e Leposaviqit, si kryetar i këtij organi

ilegal u emërua Dragan Jablanović (ai u zgjodh si kryetar i komunës së Leposaviqit në zgjedhjet lokale të Kosovës në nëntor të vitit 2013). Anëtarët e këtij organi janë: Dobrivoj Gjurgjeviq, Zoran Todiç, Marka Kuzmanović dhe Radosh Mihajloviq. Për komunën e Zubin Potokut, si kryetar ilegal i këtij organi u emërua Stevan Vulović (ai u zgjodh si kryetari i komunës së Zubin Potokut në zgjedhjet lokale të Kosovës në nëntor të vitit 2013). Anëtarët e këtij organi janë: Nemanja Jakshiq, Dragisha Jovanović, Bojan Perović dhe Latinka Utviç. Serbia i ka bërë këto emërimë të strukturave paralele komunale para zgjedhjeve lokale të 3 nëntorit të vitit 2013 në Republikën e Kosovës, dhe ende vazhdon t'i mbështes ato politikisht dhe financiarisht.

Më 31 dhjetor të vitit 2015, Qeveria e Serbisë ka emëruar Bratisllav Nikoliçin, kryetarin e komunës së Shtërpçës, të zgjedhur ligjërish në zgjedhjet lokale të Kosovës në nëntor të vitit 2013, në pozitën e kryetarit të të ashtuquajturit "organ i përkohshëm komunal" i Shtërpçës. Po ashtu, si anëtarë të atij organi, Serbia ka emëruar Dragan Vleković, Nenad Filipović dhe Dragan Rexhiç.

Së fundmi, më 19 shkurt 2015, Qeveria e Serbisë ka miratuar dy vendime në lidhje me të ashtuquajturin "Teatrin Kombëtar të Prishtinës", në njërin vendim ata shkarkuan anëtarët e bordit Marinko Bozhović, Danica Andrejeviç, Dushan Qeliç, Xhevat Qorraj, Vladimir Stanojeviç dhe Gulbehar Shabović, dhe në vendimin tjetër ata emëruan anëtarët e rinj Masha Mihailović, Jelena Knezheviç, Dragan Petroviç, Snezhana Zuviç, Dejan Stojanović, Igor Damnjanović dhe Vladislav Gjerković.

Këto vendime kanë pasuar vendimet e 11 shkurtit të vitit 2015 të Qeverisë së Serbisë për ndryshimin e Vendimit për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të organeve të përkohshme të komunave në territorin e Kosovës. Vendimi nuk është i qartë, sepse nuk përmban emrat e anëtarëve të emëruar, por vetëm duke iu referuar vendimeve të viteve 2005, 2007, 2008, 2011, 2012, dhe 2014.

Më 5 shkurt 2014, Qeveria e Serbisë ka vendosur të emërojë si ushtrues detyre të Drejtorit të Qendrës Shëndetësore në Pejë, Stanislava Radovićin, dhe gjithashtu si ushtrues detyre të Drejtorit të Shtëpisë së Shëndetit në Dragash, Xhafcen Sadat. Në të njëjtën ditë ata morën vendimin për shkarkimin e Sava Stanojeviç nga pozita e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të "Qendrës Shëndetësore në Pejë".

3. "MBROJTJA CIVILE" – SHPËRBËRJA DHE INTEGRIMI I PJESËTARËVE TË SAJ

Zbatimi i Marrëveshjes për çështjen e të ashtuquajturës mbrojtje civile (MC) ka shënuar progres të rëndësishëm dhe në këtë kohë të raportimit ka arritur në fazën përfundimtare. Gjatë procesit janë shënuar përparime dhe ngecje në zbatimin e kësaj Marrëveshjes e cila parasheh shpërbërjen e të ashtuquajturës "mbrojtje civile", që është formuar në mënyrë të paligjshme nga Serbia dhe e cila ka operuar në Kosovë si strukturë e njësisë parashtarake për gati gjashtëmbëdhjetë vite. Marrëveshja është arritur më 26 mars 2015, pas pothuajse dy vite të negociatave. Marrëveshja është nënshkruar nga të gjitha palët, nga kryenegociatorja e Kosovës për dialogun teknik, Ministrija Edita Tahiri, nga kryenegociatori i Serbisë, Marko Gjuriç, dhe nga ana e BE-së Bernd Thran.

Marrëveshja parasheh këto komponentë: (1) shpërbërjen e plotë të të ashtuquajturës "mbrojtje civile", (2) integrimin e pjesëtarëve të saj në institucionet qendrore civile të Republikës së Kosovës dhe (3) ndryshimet ligjore të Serbisë për të ndërprerë funksionimin e kësaj strukture të paligjshme në Kosovë.

1. Integrimi i ish pjesëtarëve të MC-së në institucionet civile të Kosovës

Procesi i integritimit të ish pjesëtarëve të MC-së (gjithsej 483 sosh) është duke u zhvilluar në përputhje me ligjin e Kosovës mbi Shërbimin Civil, siç është paraparë në Marrëveshje. Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për t'i integruar ata në Ministrinë dhe agjencitë që kanë veprimtari në nivelet lokale, por deri më sot nuk kanë qenë në gjendje që të veprojnë për shkak të ndërhyrjeve të Serbisë. Pozita të punës iu janë ofruar 433 personave, ndërsa 50 pozita do të mbulohen nga fondi për kontigjenca për një periudhë të përkohshme, që do të thotë se ata do të marrin paga, por vendet përfundimtare të punës do të përcaktohen në sektorin publik brenda 3 viteve.

Dinamika e procesit të rekrutimit është duke përparuar, siç kërkohet në Marrëveshje, me vonesa të kohëpaskohshme të shkaktuara nga përfaqësuesi i ish-MC në panel i cili kërkon kohë për "konsultime me Beogradin." I gjithë personeli i integruar ka paraqitur para panelit aplikacionet për punësim sipas konkursit të shpallur nga institucionet e Qeverisë së Kosovës, përveç kësaj ata kanë paraqitur dokumente të vlefshëm personale të Republikës së Kosovës. Policia e Kosovës së bashku me EULEX-in kanë bërë verifikimin e sigurisë për të gjithë, me këtë rast kanë gjetur se 50 persona në listë kanë dosje kriminale dhe të njëjtit duhet të ofrojnë prova pastërtie nga ana e institucioneve të drejtësisë së Kosovës dhe t'i paraqesin ato para panelit.

Sipas marrëveshjes, 105 kontratat e para janë nënshkruar, 80 persona tanimë janë të punësuar në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave dhe kanë nënshkruar kontratat e tyre më 1 korrik 2015, dhe 25 të tjerë janë integruar në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Sipas udhëheqësit të procesit të integrimit, Besnik Osmani, Sekretar i Përhershëm i MAPL-së, falë procesit të vazhdueshëm të rekrutimit, numri i personave të përzgjedhur ka arritur në 437, ndërsa rekrutimi i pjesës tjetër të 46 personave do të finalizohet kah fundi i shtatorit. 50 prej tyre do të akomodohen në fondin e kontigjencës, duke rezultuar kështu në numrin e përgjithshëm prej 483. Sipas marrëveshjes, procesi i rekrutimit do të përfundoj në shtator të vitit 2015.

Plani i integrimit dhe dinamikat e zbatimit

	INSTITUCIONI	Planifikuar	Përfunduar	Në proces
1.	AGJENCIA E MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE	80	80	0
2.	SHËRMBIMI KORREKTUES I KOSOVËS	25	25	0
3.	MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE	25	25	0
3.	MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	20	20	0
4.	MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	30	30	0
5.	MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	4	4	0
6.	AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË	6	6	0
7.	AGJENCIA PËR MBROJTJEN E PYJEVE	20	18	2
8.	ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS	20	7	13
9.	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	20	20	0
10.	MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS	30	30	0
11.	MINISTRIA E KULTURËS , RINISË DHE SPORTIT	20	20	0
12.	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIËS	25	24	1
13.	MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL	12	12	0
14.	AGJENCIA E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT	16	5	11
16.	AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS	10	10	0
17.	AGJENCIA SHTETËRORE E ARKIVAVE	10	9	1
18.	AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS	6	6	0
19.	AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË	20	6	14
20.	DOGANA E KOSOVËS	20	20	0
21.	AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	10	10	0
22.	MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN	4	0	4

22.	FONDI I KONTIGJENCËS	50	50	0
	TOTALI	483	437	46

2. Shpërbërja e "MC-së"

Marrëveshja parasheh shpërbërjen e "MC-së", që nënkupton mbylljen e të gjitha objekteve, zyrave dhe depove, si dhe pikave të vëzhgimit, dhe largimin e pajisjeve dhe uniformave. Të gjithë do t'i dorëzohen institucioneve të Kosovës.

Dorëzimi i objekteve të ish MC-së tek Qeveria e Kosovës

Dorëzimi i objekteve të "MC-së" nuk ka ndodhur ende, edhe pse ka kaluar afati. Marrëveshja ka parapare që dorëzimi i objekteve do të fillojë pasi që paneli t'i vërtetoj lehtësuesit të BE-së integrimin e 105 anëtarëve të MC-së. Procesi do të jetë gradual, duke përfunduar jo më vonë se 20 korrik 2015. Por, kjo pikë e marrëveshjes ende është e pazbatuar, lehtësuesi i BE-së i ka konfirmuar zyrtarisht Qeverisë së Kosovës më 18 shtator 2015, se pala tjetër ka dështuar të përmbush detyrimin e tyre që rrjedh nga marrëveshja.

Më 5 gusht 2015, u organizua një vizitë e përbashkët në komunat veriore për të verifikuar objektet e përdorura nga ish MC-ja. Në vizitë morën pjesë përfaqësuesit e Qeverisë, Besnik Osmani, Dren Zeka, Fitim Sadiku, Naim Rexha dhe Hajdar Paçarada. Sipas listës së paraqitur nga BE-ja, është identifikuar se MC-ja ka përdorur 15 objekte (zyra dhe depo) në 7 lokacione të ndryshme, pesë zyra dhe një depo në Leposaviq, pesë zyra dhe një depo në komunën veriore të Mitrovicës, dy zyra në Zveçan dhe një në komunën e Zubin Potokut.

Sipas lehtësuesit të BE-së, pala tjetër pretendon se objektet e ish MC-së i përkasin komunave veriore, dhe për këtë arsyeje MC-ja nuk ka të drejtë që t'i dorëzojë ato. Ne e konsiderojmë këtë arsyetim si të pabazuar, sepse ata është dashur ta dinë këtë çështje më herët dhe ta shpalosin atë gjatë negociatave. Në shenjë mirëkuptimi, ne kemi kërkuar dëshmi për një pretendim të tillë, dhe pastaj t'i adresojmë zgjidhjet e mundshme. Dorëzimi i objekteve është pjesë shumë e rëndësishme e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, sepse është dakorduar për t'i përdorur ato si zyra të institucioneve të ndryshme të Kosovës të cilat janë duke punësuar stafin e ish MC-së.

Dorëzimi i pajisjeve të ish MC-së tek Qeveria e Kosovës

Dorëzimi i pajisjeve të ish MC-së tek Qeveria e Kosovës, ka përfunduar më 25 gusht 2015. Pajisjet janë dorëzuar në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave në Kosovë.

Largimi i pikave të vëzhgimit

Më 20 prill 2015 është dashur të largohen tri pika të vëzhgimit në rrugën ndërmjet Mitrovicës dhe Jarinjës, ndërsa ato janë larguar pas dy muaj vonese, me 11 qershor 2015.

Pika e vëzhgimit e cila ndodhej në urën kryesore të Mitrovicës, iu është dorëzuar Policisë së Kosovës më 13 gusht 2015, dhe është larguar plotësisht nga Policia e Kosovës dhe EULEX-i më 14 shtator 2015, me vonesë prej rreth pesë muajve, pasi që afati i fundit ka qenë 20 prill 2015.

Sipas udhëheqësit të procesit të shpërbërjes, Dren Zeka, procesi i zbatimit ka përfunduar në pjesën më të madhe, përveç dorëzimit të objekteve, pasuar me vonesa në secilin veprim të parashikuar nga marrëveshja.

3. Rregullimet ligjore të Serbisë për të ndërprerë funksionimin e kësaj strukture ilegale në Kosovë

Siç është raportuar nga lehtësuesi i BE-së, Serbia ka informuar si në vijim:

Më 22 korrik 2015, lehtësuesi i BE-së Bernd Thran ka konfirmuar pranimin e letrës së shkruar të konfirmimit nga Serbia, se stafi i MC-së nuk do të veshin më uniformat/xhaketat me siglën e MC-së serbe, dhe posaçërisht do të ndërpresin përdorimin zyrtar të tyre. Marrëveshja ka paraparë që kjo do të ndodhë pas integritit të 105 personave të parë, nënshkrimi i kontratave u zhvillua në mes të datave 1 dhe 10 korrik të vitit 2015 (AME më 1 korrik, SHKK më 10 korrik 2015). Me disa vonesa të vogla, Serbia ka konfirmuar mospërdorimin e xhaketave të MC-së.

Më 29 prill, lehtësuesi i BE-së ka konfirmuar pranimin e konfirmimit me shkrim nga Serbia, në lidhje me Pikat 19 dhe 20 për ndërprerjen e pagave dhe ofrimit të mjeteve financiare për MC-në në Kosovë nga 1 shtatori i vitit 2015. Ndërprerja e pagave nga ana e Serbisë, duhet të jenë në sinkronizim me fillimin e pagave nga ana e Kosovës. Kjo do të ndodhë në përputhje me kohën kur do të filloj ndarja buxhetore në Kosovë.

Më 29 prill 2015, Serbia ka informuar lehtësuesin e BE-së zyrtarisht me shkrim, se MC-ja në Kosovë nuk do të ekzistojnë më në kuadër të sistemit të Serbisë që nga 1 shtatori 2015.

Konfirmimet e përmendura më sipër mbeten për t'u verifikuar, posa të ketë përfunduar procesi i zbatimit të integritit dhe të zgjidhet çështja e dorëzimit të objekteve.

4. DREJTËSIA

Zbatimi i Marrëveshjes së Drejtësisë, e arritur më 9 shkurt 2015, ka shënuar progres të dukshëm, ndonëse disa çështje ende duhet të zgjidhen. Kjo marrëveshje përfshiu një sërë veprimesh që do të ndërmerren me qëllim të krijimit të sistemit unik të drejtësisë së Kosovës në pjesën veriore të Kosovës, si dhe plotësimin e kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në marrëveshje, që ka për qëllim integrimin e serbëve në veri, përkatësisht gjykatësve dhe prokurorëve në sistemin Gjyqësor të Kosovës.

Ministria e Drejtësisë e cila është përgjegjëse për zbatimin, në raportin e saj të detajuar mbi gjendjen e zbatimit, paraqet informatat ne vijim:

Për të përmbushur marrëveshjen, ishte e nevojshme të ndërmarrën disa hapa në mënyrë që të arrihet zbatimi i plotë i marrëveshjes, duke përfshirë por jo i kufizuar në: shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarë, prokurorë dhe staf mbështetës, përcaktimin e pozicioneve të qarta dhe përfundimi i procesit të përzgjedhjes së këtyre vendeve të lira të punës, që për pozitat e gjyqtarëve dhe prokurorëve do të përmbillet me emërimin nga ana e Presidentes; duke bërë të gjitha aranzhimet për funksionalizimin e objekteve të caktuara për prokurorinë dhe gjykatën.

Procesi i funksionalizimit të plotë të selisë së gjykatës dhe prokurorisë në veri është në proces të finalizimit, ka pasur përpjekje të mëdha nga ana e institucioneve të Kosovës për t'i përmbushur detyrimet. Është shënuar progres i dukshëm në përmbushjen e obligimeve. Megjithatë, procesi është zgjatuar në disa aspekte, për arsye të cilat janë jashtë kontrollit të palëve të interesuara.

Progres në çështje të veçanta:

Procesi i rekrutimit të Gjyqtareve dhe Prokurorëve

a. Marrëveshja mbi numrat dhe pozitat për gjyqtarë dhe prokurorë - Pas arritjes së marrëveshjes më 9 mars, u zhvilluan diskutime në lidhje me shpërndarjen e pozitave dhe që shpalljet të bëhen për tërë territorin e Kosovës. Pas diskutimit dhe kërkesave, shpalljet përfundimtare janë bërë për 48 gjyqtarë dhe 15 prokurorë për tërë territorin e Kosovës.

b. Shpallja e vendeve të lira dhe procesi i përzgjedhjes - sipas marrëveshjes gojore vendet e lira janë shpallur më 25 mars nga të dy Këshillat, në uebfaqe dhe përmes mjeteve tjera,

duke ftuar kandidatët e kualifikuar që të aplikojnë për këto pozita. Shpalljet kanë qenë të hapura për 2 muaj, deri më 25 maj, periudhë e cila ishte konsideruar e arsyeshme për aplikuesit. Procesi i përzgjedhjes ka shkuar pa probleme, kandidatët iu janë nënshtruar procesit të përzgjedhjes, i cili është zhvilluar me ndihmën e EULEX-it.

c. Emërimi i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve – Si rezultat final i procesit të përzgjedhjes, janë përzgjedhur 34 gjyqtarë dhe 9 prokurorë, të cilët i plotësonin kriteret e kërkuara sipas konkursit. Emrat e kandidatëve në fjalë pas miratimit nga ana e KGJK-së dhe KPK-së i janë dërguar Presidentes për emërim si gjyqtarë dhe prokurorë.

d. Rishpallja e konkursit për pozitat të cilat nuk janë plotësuar - Në takimin që u mbajt në Bruksel ndërmjet përfaqësuesve të Kosovës (KGJK dhe KPK) dhe përfaqësuesve të BE-së, këta të fundit ngritën çështjen e pozitave të cilat nuk janë plotësuar për shkak të mungesës së kandidatëve të përshtatshëm. Kërkesa e BE-së ishte që të ri-shpallen konkurset për vendet e lira në të njëjtën mënyrë si herën e parë, me qëllim të integritimit. Pala kosovare pohoi se kjo ishte një ushtrim i njehershëm, kështu që çfarëdo hapi i mëtejshëm në këtë mënyrë duhet të analizohen me kujdes para se të merret ndonjë veprim. BE-ja ka kërkuar që vendet e lira të hapen në të njëjtën mënyrë si herën e parë, me qëllim të integritimit, pra procedura, panelet përzgjedhëse të EULEX-it dhe pikat tjerat, dhe ndoshta emërimi të bëhet në të njëjtën kohë. Në këtë aspekt, KGJK-ja ashtu edhe KPK-ja kanë miratuar rregulloret përkatëse mbi provimin me shkrim si kriter i veçantë juridik i paraparë me ndryshimet në Ligjin për Gjykatat dhe në Ligjin për Prokurorin e Shtetit.

e. Institucionet e Kosovës janë dakorduar për ri-shpalljen e pozitave që duhet plotësuar - 14 pozita për gjyqtarë dhe 6 për prokurorë.

f. Shpallja do të bëhet posa të konfirmohet propozimi për stafin administrativ.

Stafi mbështetës

Sipas marrëveshjes së arritur në muajin shkurt, institucionet e Kosovës kanë qenë të gatshme për të shpallur vendet e lira të punës me përshkrimin e plotë të pozitave në muajin prill.

Për më tepër, institucionet e Kosovës kanë ofruar menjëherë listat e serbeve që punojnë në gjykata dhe në zyrat e prokurorive në Kosovë, me qëllim të identifikimit të qartë të personave të cilët ndodhen në sistem, të cilët janë të përshtatshëm për integrim, në

mënyrë që të mos shmanget mirësia. Megjithatë, një akt i tillë nuk ishte bërë asnjëherë nga pala serbe, pra sigurimi i listave të sakta të individëve me qëllim të integritimit.

Megjithatë, BE-ja duke u bazuar se shpallja për gjyqtarët dhe prokurorët është publikuar për tërë territorin e Kosovës, ka sugjeruar që numri i stafit mbështetës duhet të rritet. Kërkesa është për një numër prej 168 prestarëve të stafit mbështetës, dhe fillimisht edhe që administratori i gjykatës të jetë serb, si shtesë e propozimit të dakorduar që administratori i prokurorisë të jetë serb. Për më tepër, pala serbe ka kërkuar si alternativë edhe 3 pozita menaxheriale.

Institucionet e Kosovës kanë paraqitur pozicionin përfundimtar në lidhje me numrin e stafit. Po ashtu pozita e Administratorit të zyrës së prokurorisë të jetë serb, dhe gjithashtu edhe që zëvendës administrator i gjykatës të jetë serb, dhe një zëvendës administrator për Divizionin e Apeleve, si dhe një udhëheqës të zyrës së gjendjes civile.

Pala serbe ka insistuar që numri të jete me i lartë dhe që pozita e administratorit të gjykatës të jetë serb. Një propozim i tillë nuk u pranua nga pala kosovare.

Propozimi i mësipërm i palës kosovare qëndron në tavolinë, dhe ende nuk ka asnjë përgjigje nga ana e palës serbe. Pranimi i propozimit të tillë do të trasonte rrugën jo vetëm për shpalljen e vendeve të lira për stafin mbështetës, por edhe për ri-shpalljen e vendeve të lira për pjesën e mbetur të pozitave për gjyqtarë dhe prokurorë. (Shih shtojcën, propozimin e institucioneve të Kosovës).

Ndërtesat

Me qëllim të sigurimit të një fillimi të duhur dhe funksional të punës së gjykatës dhe të zyrës së prokurorisë, institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë masa të ndryshme për të siguruar se objektet e caktuara nga marrëveshja të jenë të gatshme në kohë për përdorim. Ka pasur pengesa në këtë proces dhe përpjekje për t'i tejkaluar këto pengesa. Ka pasur arritje pozitive në këtë drejtim me sfida që ende kërkojnë për t'u tejkaluar pjesërisht. Më shumë hollësi janë paraqitur në vijim:

a. Ndërtesa e Jugobankës

Sipas marrëveshjes ish-ndërtesa e Jugobankës është përcaktuar të përdoret si ndërtesë për Gjykatën. Në mënyrë që të sigurohemi se janë ndërmarrë hapat për të lehtësuar komunikimin me Agjencinë e Privatizimit dhe si rezultat KGJK-ja ka arritur një marrëveshje për qira, për ta marr me qira prej datës 1 korrik e tutje. Pas kësaj ka angazhuar një kompani për ta bërë pastrimin e detajuar të objektit. Procesi i pastrimit është kryer dhe ndërtesa është në fazën finale të përgatitjes për përdorim, pas mobilimit. EULEX-i është zotuar se do të japë një donacion prej 300 kompjuterësh, për të ndihmuar fillimin e punës. Çështja është vënë në pritje deri në zhvillimin e mëtejshëm të procesit të integritimit.

b. Ndërtesa e Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore (ZAMV)

Në mënyrë të ngjashme, institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë masa për të siguruar se ndërtesa ku gjendet ZAMV, të lirohet me qëllim të përdorimit si zyre e Prokurorisë.

Procesi ka ngecur për shkak të mungesës së përgjigjes pozitive nga kryetari i komunës së Mitrovicës së Veriut për të zhvendosur stafin në një ndërtesë tjetër pas një kërkesë nga Kryeprokurori i Shtetit. Çështja është ngritur në shumë forume si shqetësuese për shkak të faktit se pa gatishmërinë e kryetarit të komunës, personeli nuk mund të zhvendoset në një ndërtesë tjetër. Prandaj, kanë vazhduar përpjekjet për të diskutuar me kryetarin e komunës.

Pas refuzimit të kryetarit të komunës për të zhvendosur personelin në një ndërtesë tjetër për shkak të pamundësisë për ta bërë këtë për shkak të pajisjeve të sistemit që janë të instaluar në ndërtesën e tanishme, me ndihmën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është identifikuar një ndërtesë tjetër afër ndërtesës së ZAMV-së me qëllim të përdorimit si zyre e prokurorit, duke u mbështetur në klauzolën e marrëveshjes “.....ose çdo ndërtesë tjetër që miratohet nga palët”. Sipas një raporti të Ministrisë kjo do të jetë e përkohshme, duke pasur parasysh projektet për ndërtesat e reja që do të ndërtohen. Është realizuar një vizitë e përbashkët tek ndërtesa dhe procesi është duke pritur konfirmimin nga pala serbe.

c. Zubin Potoku dhe Leposaviqi

Ndërtesa në Leposaviq është e gatshme për përdorim, edhe pse për momentin ndërtesa është zënë nga gjykatësit serbë që do të integrohen.

Ndërtesa e Zubin Potokut është liruar nga stafi i qendrës mjekësore lokale, të cilët e kishin zënë ndërtesën (në gjysmën e shtatorit). KGJK-ja do të hap një proces të ri-tenderimit për renovimin e gjykatës, planet janë duke u realizuar.

Ngjashëm si me stafin, Serbia duhet të miratojë ligjin përmes së cilit do të mbyll gjykatat dhe zyrat e prokurorisë, të cilat i ka financuar në Kosovë.

Çështjet në pritje

- Sipas marrëveshjes së arritur, gjyqtarët dhe prokurorët e përzgjedhur, para se të emërohen, duhet të dëshmojnë se më nuk do të kryejnë asnjë funksion si gjyqtarë dhe prokurorë në kuadër të Autoritetit të Serbisë. Për këtë çështje, Serbia është detyruar të miratojë një ligj të veçantë, përmes të cilit gjyqtarët dhe prokurorët në fjalë do të përfshihen në skemën e tyre të pensionimit të hershëm, dhe nuk do të veprojnë më. Deri më tani nuk ka asnjë informacion se një ligj i tillë është miratuar.
- Propozimi i Kosovës për çështjen e Stafit Administrativ/Mbështetës është në tavolinë. Kur të pranohet një propozim i tillë nga pala serbe, institucionet e Kosovës mund të ecin përpara me shpalljen e vendeve të lira të punës për pjesën e mbetur të pozitive për gjykatësit dhe prokurorët dhe stafit mbështetës. Përveç kësaj, pala serbe duhet të ofroj listat me numrin e saktë të njerëzve për qëllime të integritetit.
- Konfirmimi në pritje nga pala serbe për çështjet e ndërtesave për zyrën e prokurorisë për shkak të pamundësisë së ZAMV-së që të përdoret për atë qëllim.
- Miratimi i një ligji nga Serbia që të mbyll në mënyrë formale lidhjet me gjykatën dhe zyrën e prokurorisë.

Një shënim mbi historikun – i tërë procesi i zbatimit është zhvilluar në dy faza. Në fazën e parë (maj-shtator 2013) është arritur marrëveshja për shuarjen e strukturave paralele serbe të drejtësisë në Kosovë. Ato u shpërbën dhe u verifikuan nga EULEX në shtator të vitit 2013, edhe pse informacione të ndryshme janë shpërndarë lidhur me këtë çështje, duke pasur parasysh se procesi i krijimit të strukturave legale ishte duke u vonuar. (Për më shumë informata ju lutem referojuni uebfaqes zyrtare të qeverisë <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,252>). Në fazën e dytë (dhjetor 2013 - shkurt 2015), është arritur marrëveshja për themelimin e strukturave ligjore unike të Kosovës në pjesën veriore si dhe integrimin e individëve serb (gjykatësit dhe prokurorët) në institucionet e drejtësisë në Kosovë.

5. BARRIKADA NË URËN E MITROVICËS

Marrëveshja për largimin e barrikadës nga Ura e Mitrovicës, e arritur më 25 gusht 2015 më në fund do t'i përmbyll tensionet dhe frustrimin e krijuar nga kjo barrikadë për më shumë se pesëmbëdhjetë vite dhe tensionet e ringjallura nga viti i kaluar kur kjo barrikadë në vend se të hiqet është zëvendësuar me një tjetër të quajtur me një term më të butë "parku i paqes". Marrëveshja parasheh veprimet e mëposhtme:

Më 15 tetor 2015 do të hiqet barrikada (e ashtuquajtur "parku i paqes") nga Ura e lumit Ibër në Mitrovicë nga ana e BE-së. Rivitalizimi i urës do të zbatohet dhe financohet nga BE në pajtim me planet e miratuara simetrike në dy anët e lumit Ibër. Ura do të hapet për lëvizje të lire të automjeteve dhe këmbësorëve jo më vonë se në qershor të vitit 2016. Marrëveshja i jep fund ndarjes së Mitrovicës, sepse 15 vite pas luftës në Kosovë, ura nga një urë ndarëse do të kthehet në një urë bashkimi për qytetarët, qytetin dhe Kosovën.

Kjo marrëveshje i jep fund ndërtimeve ilegale dhe qëllimeve të Serbisë që të ndryshojë strukturën etnike në fshatrat Suhadoll dhe Kroi i Vitakut, përmes mbështetjes së Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe dy kryetarëve të komunave të Mitrovicës për Planin Zhvillimor Komunal, në përputhshmëri me vijat administrativ të zonave kadastrale të këtyre dy fshatrave, siç përcaktohet nga ligjet e Republikës së Kosovës..

BE-ja dhe Grupi i Punës në bashkëpunim me kryetarët e dy komunave do të monitoroj rregullisht gjendjen politike dhe të sigurisë gjatë procesit të rivitalizimit.

6. ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË KOSOVË

Marrëveshja mbi parimet bazë të themelimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë është arritur më 25 gusht 2015 në Bruksel.

Marrëveshja është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet e saj. Asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk do të jetë një nivel i tretë e qeverisjes në Republikën e Kosovës.

Asociacioni do të jetë një strukturë e përbërë nga komunat me shumicë serbe, i cili do të veproj në pajtim të plotë me ligjet e Republikës së Kosovës, që do t'u ndihmojë komunave

në realizimin e çështjeve të tyre lokale. Asociacioni nuk ka të drejtë të merr vendime për komunat e as në emër të komunave të tyre anëtare, meqë sipas Ligjit të Kosovës, komunat kanë kompetenca ekskluzive për çështjet lokale dhe këto kompetenca nuk mund të barten tek Asociacioni. Asociacioni nuk do të ketë shërbyes civilë por vetëm punëtor të zakonshëm. Asociacioni nuk do të ketë mundësinë të ofrojë shërbime tek qytetarët, por vetëm tek komunat e saj anëtare. Ligji i Kosovës mundëson krijimin e më shumë asociacioneve të komunave në shtetin e Kosovës, prandaj, krijimi i këtij asociacioni është në përputhje me ligjet e shtetit tonë dhe me Kartën Evropiane për Qeverisjen Lokale.

Përmes kësaj marrëveshje, Kosova do ta forcojë sovranitetin e saj si një shtet unitar në pajtim me Kushtetutën e saj. Kushtetuta përcakton sistemin politik të Kosovës në dy nivele të qeverisjes, nivelin lokal dhe qendror. Në bazë të marrëveshjes, Asociacioni do të kontribuojë në integrimin e plotë të serbëve në kuadër të sistemit kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, që do të rezultojë me shuarjen e të gjitha strukturave paralele të Serbisë në Kosovë. Serbia është pajtuar të themeloj Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë, në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin e saj.

Asociacioni nuk do të jetë një organizatë buxhetore e Republikës së Kosovës. Ai mund të përfitojë nga fondet e brendshme dhe të jashtme, ngjashëm sikurse Asociacion tjetër ekzistues i komunave të Kosovës. Asociacioni do t'i nënshtrohet auditimit dhe ligjeve të prokurimit të Republikës së Kosovës. Secili financim dhe shpenzim i tij do të jetë brenda dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm të Republikës së Kosovës. Asociacioni nuk ka karakter mono-etnik meqë është Asociacion i komunave me shumicë serbe, ndaj në bazë të të dhënave zyrtare ai është i përfaqësuar me rreth 15% nga komuniteti shumicë shqiptar dhe nga komunitetet tjera. Karakteri shumetnik i këtyre komunave po ashtu do të pasqyrohet edhe në përbërjen e strukturës së këtij Asociacioni; e njëjta vlen edhe për simbolet e saj të cilat duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e Kosovës dhe të reflektojnë karakterin shumetnik të saj.

Organet e Asociacionit do të jenë të ngjashme me Asociacionin ekzistues të Komunave të Kosovës dhe si i tillë, ky Asociacion nuk do të kryej funksione tjera përveç atyre të përcaktuara me ligjet e Kosovës. Roli i tij do të jetë vetëm të përfaqësoj dhe lehtësoj funksionimin normal të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Asociacioni mbron dhe promovon interesin e anëtarëve të saj. Në lidhje me institucionet qendrore, ai gjithashtu promovon të drejtat e komuniteteve. Mbrojtja dhe promovimi i tyre është në interesin e institucioneve të Kosovës. Të gjitha detyrat dhe objektivat e Asociacionit janë të kufizuara në aspektin e përgjithshëm mbi çështjet lokale, pa pasur mundësinë e marrjes së

autorizimit për menaxhimin e çështjeve lokale dhe as pengimin e funksionimit normal të autoriteteve publike në nivelin qendror dhe lokal të Republikës së Kosovës. Autoriteti publik i mbetet ekskluzivisht Qeverisë së Republikës së Kosovës ose komunave varësisht nga lloji i kompetencave publike. Vendimet e Asociacionit nuk do të jenë të detyrueshme për komunat e saj anëtare. Komunat i kanë kompetencat dhe përgjegjësitë e parapara me ligj dhe me mbikëqyrje administrative nga ana e Qeverisë në pajtim me ligjin.

Asociacioni mund të ketë në pronësi të tij pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme sipas kushteve dhe rregullave të njëjta si Asociacioni ekzistues i Komunave të Kosovës, por në asnjë mënyrë nuk mund të jetë pronar i pasurisë publike të Kosovës, pavarësisht a është pasuri e nivelit qendror apo lokal. Asociacioni nuk do të ketë rol në menaxhimin e pasurive dhe resurseve natyrore të Kosovës. Asociacioni mund të lirohet nga taksat në pajtim me ligjet përkatëse të Kosovës, që e rregullojnë këtë çështje. Asociacioni përfaqësohet nga organet e tij brenda dhe jashtë Kosovës, në të njëjtën mënyrë si dhe asociacioni ekzistues, në pajtim me ligjet e Kosovës. Anëtarësimi i komunave në Asociacion bëhet në baza vullnetare, si dhe tërheqja e tyre. Prandaj, kemi të bëjmë me një organizatë të natyrës vullnetare, siç është promovuar nga Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale.

Procesi i zbatimit përfshin hapat në vijim

Qeveria e Kosovës miraton dekretin për procedurat e themelimit të Asociacionit, i cili i nënshtrohet rishikimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Ajo pasohet nga procesi i hartimit të statutit nga ekipi menaxhues dhe nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), brenda katër muajve, me lehtësim nga ana e BE-së. Në të njëjtën periudhë, procesi i shpërbërjes së strukturave paralele të Serbisë në Kosovë do të kryhet me lehtësim nga ana e BE-së. Kjo do të sigurojë kushtet e nevojshme sipas të cilave mund të themelohet Asociacioni. Statuti do të miratohet me dekret të Qeverisë së Kosovës në bazë të marrëveshjes gjatë procesit të Dialogut. Çfarëdo ndryshime të mundshme, të paraqitura nga Asociacioni do të miratohen me dekret të Qeverisë dhe do të rishikohen nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Marrëveshja për telekomunikacionin, respektivisht Plani i Veprimit për Telekomunikacion është arritur dhe nënshkruar më 25 gusht 2015. Marrëveshja parasheh çështjet në vijim:

Kodin shtetëror për Kosovën

Kosovës do t'i ndahet kodi shtetëror 383 nga ITU (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit) më 15 janar 2016. Më 15 nëntor 2015, Austria do të aplikojë në emër të Kosovës për të kërkuar nga ITU që të ndajë kodin shtetëror për Kosovën. Kosova do t'i ketë të gjitha të drejtat shtetërore për të administruar kodin telefonik si të gjitha vendet tjera. Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) do të bashkëpunojë me ITU-në për zbatimin e Kodit telefonik për Kosovën. Kosova do të ketë vetëm një kod. Të gjitha kodet tjera ekzistuese 381, 377, 386 do të pushojnë së ekzistuari sepse do të shndërrohen në kodin 383.

Rreth telefonisë mobile – një autorizim i përkohshëm për veprim të kufizuar për një kompani të re

Një autorizim i përkohshëm për një veprim të kufizuar të aktiviteteve të telefonisë mobile do t'i ofrohet një kompanie të re, që do të regjistrohet sipas ligjeve të Kosovës, më 15 janar 2016.

Ky nuk do të jetë një operator i tretë mobil në Kosovë, sepse për këtë nevojitet tenderim ndërkombëtar me shumë konkurrent siç parashihet në legjislacionin e Republikës së Kosovës. Ky autorizim i përkohshëm për këtë kompani do të skadojë pas përfundimit të tenderit ndërkombëtar për operatorin e tretë mobil.

Rreth telefonisë fikse- një licence e plotë për një kompani të re

Një kompanisë së re do t'i jepet një licence për telefoninë fikse siç parashihet me ligjin e Kosovës.

Regjistrimi i biznesit të kompanisë së re

Procesi i regjistrimit të biznesit të kompanisë së re në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) është duke u zhvilluar. Dokumentet e aplikimit janë dorëzuar nga kompania e re, një degë e kompanisë serbe, më 2 shtator 2015. Pas shqyrtimit të aplikacionit, më 4 shtator 2015, ARBK-ja informoi përfaqësuesin zyrtar të kompanisë rreth disa parregullsive dhe ofroi udhëzime me shkrim për korrigjimet e

kërkuara në aplikacion, që të jetë në përputhshmëri me Ligjet e Kosovës, siç përcaktohet në marrëveshjen e Brukselit për telekomunikacion. Ministrja e Dialogut ka informuar rregullisht BE-në për këtë proces duke bërë thirrje që korrigjimet të bëhen në mënyrë të duhur. Më 11 shtator 2015, kemi pranuar aplikacionin e korrigjuar të kompanisë së re, e cili kryesisht ishte rregulluar me përjashtim të termit "degë", për të cilin kompania kishte përdorur termin "kompani vartëse", i cili nuk është në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Ne vazhduam konsultimet me BE-në, në mënyrë që të zgjidhim këtë problem dhe BE-ja sugjeroi që terminologjia duhet të merret nga Ligji i Kosovës për regjistrimin e biznesit, në përkthimin zyrtar në gjuhën serbe. Në këtë linjë, ARBK-ja kërkoi nga kompania e re që t'i ndryshoj dokumentet e aplikimit më 11 shtator 2015, ndërsa premtoi se pas pranimit të ndryshimeve, menjëherë do të lëshojë një certifikatë të biznesit për kompaninë e re.

Më 17 shtator 2015, ARBK dërgoi një përkujtim tek kompania e re, megjithatë deri më tani nuk ka pasur ndonjë përgjigje nga ta.

Operatorët ilegalë do të pushojnë së funksionuari

Të gjithë operatorët ilegalë të Serbisë së telefonisë fikse dhe mobile në Kosovë do të ndërpriten, pas 15 vitesh të operimit ilegal, që nga përfundimi i luftës në Kosovë më 1999. Thirrjet nga Kosova në Serbi dhe anasjelltas do të jenë thirrje ndërkombëtare.

Kosova ka dërguar në mënyrë të duhur pakon e parë të të dhënave teknike

Siç parashihet në pikën 2.2 të Planit të Veprimit për Telekomunikacion, më 18 shtator 2015, Kosova ka dërguar pakon e parë të të dhënave teknike tek BE-ja me qëllim të shkëmbimit të tyre në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Çështjet tjera relevante

Do të ketë një marrëveshje për roaming dhe ndërlidhje në mes të dy shteteve, gjegjësisht në mes të operatorëve mobile të të dyja shteteve, në mënyrë që të ulin çmimet e shërbimeve për qytetarët dhe për rritjen e të hyrave të përgjithshme për shtetin tonë.

Pengesat për kalimin nga transmetimi analog në atë digjital do të zgjidhen, ku Republika e Kosovës do të hap rrugën e saj për caktimin e kanaleve në pika të mjaftueshme transmetuese, për mbulimin e tërë territorit pa pengesa dhe ndërhyrje.

Marrëveshja hap rrugën drejt arritjes së marrëveshjes teknike në shërbimet postare.

8. ENERGJIA

Zbatimi i Marrëveshjes së vitit 2013 mbi Energjinë ka ngecur për më tepër se një vit për arsye se Serbia në kundërshtim me këtë marrëveshje, ka penguar KOSTT-in në vendosjen e marrëdhënieve operacionale me ENTSO-E, dhe gjithashtu ka bërë përpjekje për të devijuar nga marrëveshja me pretendime për distribucion të energjisë, gjë që nuk është paraparë në këtë marrëveshje.

Marrëveshja/Konkluzionet e 25 gushtit 2015 shërbejnë si një marrëveshje për zhbllokimin e procesit të zbatimit të Marrëveshjes për Energji e arritur në vitin 2013. Këto konkluzione kanë bërë edhe një herë të qartë se Serbia duhet të respektoj Marrëveshjen e vitit 2013 për energjinë. Nënshkrimet e kryeministrave të të dy shteteve dhe Përfaqësueses së Lartë të BE-së Mogherini kanë demonstruar përkushtimin e ripërtërirë për realizimin e asaj që është dakorduar në vitin 2013.

Marrëdhëniet e KOSTT-it me ENTSO-E

Në kundërshtim me këtë marrëveshje, Serbia kishte bllokuar operatorin e sistemit të transmisionit të Kosovës (KOSTT) që të nënshkruaj marrëveshjen për lidhje me ENTSO-E që i lejon Kosovës të bëhet një zonë e pavarur rregullative në sistemin Evropian të Transmisionit. Pala Kosovare rregullisht ka raportuar tek BE-ja në lidhje me këto pengesa dhe ka bërë thirrje për zhbllokim të procesit, por për fat të keq pa ndonjë sukses. Pengesat e Serbisë ishin të natyrës politike me që refuzonte të pranonte kufirin elektrik të transmisionin e energjisë të përcaktuar ndërkombëtarisht mes Kosovës dhe Serbisë. Për më tepër, u përpoq dhe të llojoj që të shtyj kufirin elektrik më tej brenda territorit të Kosovës, duke u përpjekur që të mbaj kontrollin e saj të energjisë në pjesën veriore të Kosovës. Kosova ka qenë e vendosur dhe ka refuzuar kategorikisht tendencat e tilla negative nga ana e Serbisë, ndërsa i bëri thirrje BE-së që të mbështesë zbatimin e marrëveshjes së arritur në vitin 2013 mbi energjinë e cila vërteton kufirin elektrik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ekuivalent me vijën kufitare midis dy shteteve.

Më 9 korrik 2015, ENTSO-E votoi pro marrëveshjes për lidhje/kyçje të Kosovës/KOSTT-it me ENTSO-E, megjithatë Serbia paraqiti një ankesë kundër një vendimi të tillë.

Sidoqoftë, në saje të Konkluzioneve mbi energjinë të arritura më 25 gusht 2015, që kërkon nga Serbia që të heq pengesat e lartpërmendura dhe të respektoj Marrëveshjen e vitit 2013 mbi energjinë, Serbia më në fund ka pranuar marrëveshjen duke e tërhequr ankesën e saj.

Më 16 shtator 2015 në mbledhjen e radhës plenare të ENTSO-s është arritur përparim i duhur ku Serbia ka rënë dakord të tërheq ankesën e saj lidhur me vendimin e ENTSO për pranimin e KOSTT-it dhe ka shprehur gatishmërinë që të nënshkruaj menjëherë Marrëveshjen për Kyçje.

Si rezultat i kësaj, më 1 tetor 2015, KOSTT-i dhe ENTSO-E kanë nënshkruar marrëveshjen për lidhje/kyçje të paraprirë nga marrëveshjet dypalëshe ndërmjet KOSTT-it dhe OST-ve nga 30 shtetet, e në mesin e tyre edhe Serbia.

Kjo marrëveshje i jep fund çdo ndërhyrje të Serbisë ndaj sistemit të transmisionit të energjisë në Kosovë, dhe kërkon nga Serbia që të paguaj kompensim për përdorimin e rrugëve të transmisionit të Kosovës dhe kongjestioneve të krijuara në përputhje me Traktatin e Athinës mbi Energji.

Regjistrimi i biznesit të dy kompanive të reja, sipas Ligjit të Kosovës

Marrëveshja mbi energjinë parashih regjistrimin e dy kompanive të reja, njëra për tregtinë e energjisë dhe tjetra për shërbime të furnizimit dhe distribucionit të energjisë (shërbimet e distribucionit nënkuptojnë faturimin, grumbullimin, mirëmbajtjen si dhe kyçen fizike për klientët e rinj në katër komunat veriore). Procesi për regjistrimin e biznesit të dy kompanive të reja, filiale të kompanive serbe në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) është në zhvillim e sipër. Dokumentet e aplikimit të dorëzuara nga kompanitë e reja janë shqyrtuar nga ARBK-ja dhe udhëzimet për rishikimet e nevojshme për pajtueshmëri me ligjet e Kosovës janë dërguar tek kompanitë e reja. Pasi të pranohet aplikimi i cili është në përputhje me ligjin, ARBK-ja do të lëshojë menjëherë certifikatën e regjistrimit.

Përfaqësuesit e kompanive të reja kanë paraqitur kërkesat për regjistrimin e bizneseve të tyre në ARBK më 4 shtator 2015 duke shkelur pikat 2 dhe 6 të konkluzioneve të 25 gushtit 2015, ku thuhet se aplikacionet duhet të dorëzohen jo më vonë se në fund të gushtit të vitit 2015.

Pas shqyrtimit të këtyre dy aplikacioneve nga ana e ARBK-së, është konstatuar se dokumentacioni i aplikimit nuk është në përputhje me ligjin e Kosovës dhe me marrëveshjen e Brukselit, sepse gjuha e përdorur ishte politikisht provokuese dhe ligjrisht jo korrekte. ARBK-ja ka kërkuar rishikimet e dokumenteve përmes një letre të udhëzimeve dhe shpjegimeve për rishikime të nevojshme dërguar në mënyrë të rregullt kompanive të reja më 9 shtator 2015 (brenda afatit zyrtar prej 7 ditësh për regjistrimin e biznesit sipas Ligjit të Kosovës). Që atëherë, përfaqësuesit e kompanive të reja nuk janë përgjigjur duke krijuar vonesa në kryerjen e këtij veprimi të zbatimit.

Ministria për Dialog ka informuar rregullisht BE-në/Nicholas Cendrowicz mbi procedurat e regjistrimit të biznesit, si dhe vonesat nga pala serbe për këtë çështje.

Licencat e biznesit për dy kompanitë

Dy kompanitë e reja kanë të drejtë të marrin licencat e operimit nga autoriteti i rregullatorit për energji në Kosovë, në përputhje me kornizën rregullative të Kosovës. Tregu i hapur i Kosovës për furnizim dhe tregti të energjisë do t'iu mundësojë dy kompanive të reja të regjistruara në Kosovë që të marrin licencën për operim, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Shuarja e operatorëve ilegalë

Me nënshkrimin e Marrëveshjes, Serbia ka rikonfirmuar përkushtimin e saj për shpërbërjen e të gjithë operatorëve të saj të energjisë të cilët veprojnë ilegalisht në veri të Kosovës, një detyrim i cili u vonua që nga shtatori i vitit 2014, përkatësisht pas nënshkrimit për zbatimin e planit të veprimit mbi energjinë.

Qasja në të dhëna dhe asetet - ende në pritje

Marrëveshja parasheh qasje në të dhëna dhe asetet nga ana e KOSTT-it dhe operatorit të distribucionit të Kosovës - KEDS. Kjo çështje është ende në pritje dhe ajo duhet të zbatohet nëpërmjet lehtësimit të BE-së.

Qasja në të dhëna dhe asetet do të mundësojë normalizimin e funksionimit të sistemit energjetik të Kosovës në pjesën veriore të Kosovës, i cili ka qenë i penguar nga operatorët ilegalë të Serbisë në Kosovë.

Ky është një proces shumë i rëndësishëm, sepse ndër të tjera, do të ndihmojë në arritjen e kontratave të shërbimit për shërbime ndërmjet KEDS-it dhe Ndërmarrjes së Re për shërbime të furnizimit dhe distribucionit të energjisë (Electrosever) si dhe për masat e nevojshme për rrjetet e sistemeve të transmisionit dhe distribucionit të cilat mund të ofrojnë qasje tek Administratori efikas i Palës së Tretë (APT) për punën e Ndërmarrjes së Re për furnizim me energji elektrike.

Çështje tjera të rëndësishme

Do të ketë një komision trepalësh arbitrazhi i cili do të trajtojë çështjen e kompensimit financiar në fushën e energjisë, duke përfshirë edhe marrëveshjet për tranzitin dhe alokimet e interkonjeksionit nga viti 2004 deri në vitin 2014 dhe nga viti 2014 deri në fund të vitit 2015.

Zbatimi i Marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufijve (IBM) e arritur në vitin 2012 është në nivel të kënaqshëm në aspektin e përgjithshëm, duke përfshirë bashkëpunimin konstruktiv mes autoriteteve kufitare të të dy shteteve, si dhe hapjen e dy pikë-kalimeve të reja kufitare.

Marrëveshja për objekte të përhershme të IBM-it e arritur më 4 shtator 2014 është në proces të implementimit, edhe pse me vonesa të dukshme.

Në çështjet tjera relevante ka ende disa boshllëqe, sidomos në zbatimin e SEED, për sa i përket fushëveprimit të plotë të shkëmbimit elektronik të informatave ndërmjet palëve, dhe mbi Asistencën e Ndërsjellë Ligjore.

Objektet e përhershme të IBM-it

Vonesa të konsiderueshme janë shënuar në kontekstin e fillimit të ndërtimit të objekteve të përhershme të IBM-it në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, marrëveshja është arritur më 4 shtator 2014.

Pothuajse është arritur kontrata e PSBE-së me partnerin implementues

PSBE-ja është në proces të nënshkrimit të kontratës me partnerin implementues për ndërtimin e objekteve të cilat kanë të ngjarë të ndodhin së shpejti, kjo sipas informatave të fundit të marra nga PSBE-ja. Pala Kosovare në disa takime me PSBE-në ka kërkuar që të përshpejtohet ky proces.

Me qëllim të përshpejtimit të zbatimit, më 19 qershor 2015 u zhvillua një takim mes përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës, BE-së (Zyrës në Kosovë) dhe UNOPS-it (kontraktorit të BE-së për ndërtimin e PKK-ve të përhershme), ku u prezantua dinamika e ndërtimit të PKK-ve të përhershme.

Zyra e BE-së/Komisionit Evropian bëri të ditur se marrëveshja me UNOPS-in do të nënshkruhet më së largu në gusht të vitit 2015, dhe pas nënshkrimit të kontratës, do të filloj përgatitja e projektit/dizajnit (sipas modeleve të miratuara në Bruksel). Ideja fillestare është të fillohet me ndërtimin e PKK-së në Merdarë, dhe pas tre muajsh në Mutivodë, dhe pas 3 muajve të tjerë në Bërnjak. Ky projekt do të finalizohet për 3 vite e

gjysmë, ndërtimi do të përfundojë për 2 vite e gjysmë ndërsa viti i fundit do të jetë periudhë "garancioni", ku do të bëhet vlerësimi, korrigjimi i gabimeve të mundshme, etj

Çështjet e shpronësimit

Nga ana e saj, Qeveria e Kosovës ka miratuar të gjitha vendimet e nevojshme për çështjen e shpronësimit. Në tri takime të ndryshme, vendimi fillestar (më 27 maj 2015), ai paraprak (më 5 gusht 2015) dhe ai përfundimtar (më 16 shtator 2015) mbi shpronësimin e parcelave që preken nga ndërtimi i objekteve të përhershëm për menaxhimin e integruar të kufirit (IBM).

Përveç veprimeve të ndërmarra për shpronësimin e tokës, Qeveria e Kosovës ka përgatitur planin e veprimit me të gjitha masat që duhet të ndërmerren.

Fondet e IPA-s së BE-së për ndërtim

Më 29 qershor 2015 në Bruksel, Komiteti Drejtues i fondeve të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) i Komisionit Evropian ka miratuar financimin për ndërtimin e pikë kalimeve të përhershme kufitare në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Më 23 shtator 2015, Qeveria e Kosovës ka miratuar amendamentimin e Marrëveshjes Kornizë të IPA 2012-2013 e cila i hap rrugë Komisionit Evropian për të rialokuar fondet, përkatësisht për të mbështetur ndërtimin e Pikë kalimeve të IBM-it në Merdarë, Bërnjak dhe Mutivodë.

PKK-të e përhershme të IBM-it në Merdarë, Bërnjak dhe Mutivodë do të ndërtohen nga fondet e IPA-s për Kosovë, ndërsa PKK-të në Jarinjë, Dheun e Bardhë dhe Muçibabë do të ndërtohen nga fondet e IPA-së për Serbi, ku shuma totale e këtij investimi do të jetë 21 milion euro.

SEED

Marrëveshja mbi fushëveprimin e plotë të SEED është në pritje që një vit, sepse Serbia nuk ka gatishmëri për të pranuar marrëveshjen. Ideja e avancimit të bashkëpunimit të shkëmbimit elektronik të të dhënave (SEED) duke pasur fushëveprim të plotë të shkëmbimit shërben për kontroll më të mirë nga autoritetet doganore të të dyja shteteve. Çështja e fundit që duhet të bien dakord është terminologjia që do të përdoret, për të cilën gjë, pala Kosovare është përgjigjur pozitivisht më 5 janar 2015. Në takimin e fundit në Prishtinë, më 31 korrik 2015, Kryesuesi i GI-së së IBM-it nga BE-ja njoftoi se pala Serbe ka

treguar gatishmëri për të pranuar marrëveshjen, megjithatë pranimi i vërtetë asnjëherë nuk u konfirmua, prandaj, nuk është realizuar ende SEED-i në fushëveprim të plotë.

Asistenca e Ndërsjellët Juridike (ANJ)

Situatë e njëjtë e ngecjes është me marrëveshjen mbi Asistencën e Ndërsjellë Juridike (ANJ). Ajo është arritur në janar të vitit 2013, por zbatimi i saj, shumicën e kohës ka dështuar për shkak të palës Serbe. Ajo u ndërpre plotësisht në tetor të vitit 2014, kur BE-ja transferoi kompetencat nga EULEX-i tek PSBE-ja, sepse palës serbe nuk i ka pëlqyer roli ndërmjetësues i PSBE-së në transmetimin e kërkesave dhe përgjigjeve për ANJ-në në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në takimin e fundit të GI-së më 21 maj 2015, BE-ja ka konfirmuar dështimin e Serbisë për të zbatuar ANJ-në. Më vonë në korrik të vitit 2015, konfirmoi se pala Serbe ka premtuar të rifilloj zbatimin e ANJ-së por deri më sot nuk ka ardhur një konfirmim zyrtar nga ana e tyre.

IBM - Çështjet që lidhen Doganat

Dogana e Kosovës ka vendosur zyrtarët doganor në PKK-në në Mutivodë që nga 15 qershori i vitit 2015 sipas konkluzioneve të dakorduara nga takimi i fundit i GI-së më 21 maj të vitit 2015, i cili bën thirrje për praninë e Doganës së Kosovës gjatë periudhës së verës. Dogana e Kosovës ka zgjatur praninë e doganierëve deri në fund të këtij viti.

Në takimin e fundit të Nivelit Qendror ", palët u pajtuan se Mekanizmi i Shkëmbimit të Informacionit është përmirësuar kohëve të fundit. EULEX-i sugjeroi se pala Serbe duhet të përdor një e-mail adresë të veçantë Doganore në mënyrë që të sigurohet komunikim më i mirë (një e-mail adresë të re përveç asaj të përgjithshme që MUP-i e përdor tani). Kjo do të zvogëlojë shanset e mungesës së komunikimit që lindin si pasojë e mos arritjes së e-mail-it tek pranuesi i synuar (Dogana e Serbisë). Kjo do të ishte në harmoni me palën Kosovare, ku një e-mail adresë specifike e IBM-Doganës është tashmë në funksion. Serbia u pajtua për zbatimin e kësaj. EULEX-i gjithashtu sugjeroi që shkëmbimi i informacionit të zhvillohet vetëm në gjuhën angleze - të dyja palët ranë dakord ".

Disa vështirësi teknike janë ende duke vazhduar në PKK-në e IBM-it të administruar nga ana Serbe, kondicionerët e ajrit në PKK-në në Muçibabë/Depce janë jashtë funksionit, si dhe gjeneratori në Konçul/Dheun e Bardhë është pothuajse gjithmonë me probleme teknike.

Hapja e dy pikave të reja të kalimit kufitar

Në aspektin e lehtësimit të mëtejshëm të lirisë së lëvizjes, Kosova ka kërkuar hapjen e pikave të reja të kalimit kufitar në lokacionin tek Kapia e Svirces, e cila do të shkurtojë distancën (rreth 100 km) për shqiptarët e Luginës së Preshevës që udhëtojnë për Kosovë. Kjo kërkesë u miratua edhe nga kryetarët e dy komunave, të Kamenicës dhe Medvegjës, të cilët gjithashtu i kanë shkruar autoriteteve përkatëse për këtë çështje.

Në takimin e mbajtur në Bruksel, më 21 maj të vitit 2015, Kosova dhe Serbia ranë dakord të hapin dy pike-kalime të reja kufitare të IBM-it, njëren afër Luginës së Preshevës/Komunës së Medvegjës dhe tjetra në pjesën veriore të kufirit. U ra dakord që pala nikoqire administruese në PKK-në e IBM-it në Kapia/Vrapce të jetë Kosova dhe në PKK-në e Rajetici/Izvor të jetë pala Serbe. PKK-të do të jenë hapur 24/7 dhe me prezencë doganore vetëm gjatë ditës. Si Kosova ashtu dhe Serbia ranë dakord që të kërkojnë nga Komisioni Evropian të konsideroj përfshirjen e dy PKK-ve të reja për financim të objekteve të përhershme.

Në aspektin e implementimit, më 9 qershor 2015, është zhvilluar një vizitë e përbashkët në mes të delegacioneve të Kosovës, BE-së dhe Serbisë në PKK-në në Rajetici/Izvor, ndërsa, vizita në PKK-në e Kapia/Vrapce u zhvillua më 10 qershor 2015. Gjatë kësaj vizite, tri palët nënshkruan modelet përkatëse të projektimit për të dy PKK-të, dhe të dyja palët u zotuan për përmbushjen detyrimeve të tyre me kohë në këtë drejtim.

10. SIGURIMI I AUTOMJETEVE

Pas negociatave të gjata dhe të vështira për rreth dy vjet, më në fund u arrit Marrëveshja për sigurimin e automjeteve më 23 qershor 2015. Marrëveshja, gjegjësisht, Memorandumi i Mirëkuptimit (MM), i lehtësuar nga BE-ja dhe Këshilli i Byrove (CoB), parashikon njohjen e ndërsjellë të polisave të sigurimit të automjeteve në mes të dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë. Kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme për të mirën e qytetarëve, sepse ka hequr pagesat shtesë që qytetarët është dashur të paguajnë për sigurimin e automjeteve të tyre gjatë kalimit në shtetin tjetër. Ceremonia e nënshkrimit u bë në prani të dy kryeministrave, atij të Kosovës dhe Serbisë, si dhe Përfaqësueses së Lartë të BE-së znj. Mogherini. MM-ja nuk ka mundur të hyjë në fuqi siç kërkohej me nenin e saj të fundit, për shkak të pamundësisë së Serbisë që të përmbush disa pjesë të MM-së, por në vend të

kësaj ajo ka hyrë në fuqi më 12 gusht 2015. Më 5 gusht 2015, u zhvillua takimi mbi zbatimin e MM-së në Bruksel në selinë e Këshillit të Byrove (CoB) për të parë nëse kanë përfunduar të gjitha përgatitjet e nevojshme teknike për fillimin e zbatimit. Të dyja palët raportuan se kanë përfunduar të gjitha përgatitjet e nevojshme.

Më 12 gusht 2015, MM-ja është zbatuar në të gjitha pikat e kalimit kufitar të IBM-it ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe pala Kosovare ka bërë rregullimet e nevojshme për zbatimin e plotë të saj nëpërmjet Policisë së Kosovës në të gjitha pikat e kontrollit kufitar dhe me prezencë të personelit të BKS-së nëpër të gjitha pikat e kalimit kufitar.

Pala serbe nuk e ka funksionalizuar plotësisht PKK-në e IBM-it në Bërnjak dhe Merdare. Megjithatë, procesi i zbatimit tregoi se pala Serbe, përkundër përgatitjeve të raportuara para Këshillit të Byrove (CoB), në fakt ka dështuar në disa aspekte të zbatimit. U vu re se **jo të gjitha pikat e kalimit kufirit të IBM-it janë funksionalizuar sipas MM -së nga ana e palës Serbe.** Pikat Kufitare (PK) të IBM-it në Bërnjak dhe Merdare nuk ishin funksionalizuar, ku në Jarinjë ishte një pikë e shitjes për sigurim dhe pagesa të tabelave "proba" e cila ishte në largësi prej më shumë se 2 km nga PK-ja e IBM-it. Drejtuesit e automjeteve u nevojitej të parkonin automjetet e tyre në PK-në e IBM-it dhe të ecin për rreth 2 km në mënyrë që të marrin sigurimin e kërkuar ose që të bënin pagesën dhe përsëri të vinin në pikën e IBM-it dhe të paraqesin letrën e kërkuar tek autoritetet serbe.

11. PËRFAQËSIMI DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje vazhdon me progres te pjesshëm, sepse Serbia nuk i ka ndalur ende pengesat dhe shkeljet e marrëveshjes. Në procesin e anëtarësimit të Kosovës në organizatat relevante rajonale, gjatë periudhës raportuese Kosova është pranuar në organizatat si në vijim: Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK), është pranuar në Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA) më 14 mars 2015, në Iniciativën Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI), më 10 qershor 2015. Përveç kësaj, Kosova më 16 korrik 2015 ka aplikuar për anëtarësim në UNESCO dhe është duke lobuar intensivisht në këtë drejtim. Në nëntor të këtij viti pritet të bëhet anëtare në këtë organizatë shumë të rëndësishme

Rastet e shkeljes së marrëveshjes nga ana e Serbisë

Ka ende pengesa që vijnë nga pala Serbe, jo vetëm në parandalimin e anëtarësimit të Kosovës në organizata të reja, por edhe në organizatat ku Kosova tashmë është anëtare e barabartë. Këto janë disa shembuj:

Në takimin rajonal ministror në Budvë më 11 shtator 2015 të organizuar nga Ministria e Jashtme e Malit të Zi, Serbia ka kundërshtuar praninë e flamurit të Kosovës të shfaqur krahas flamujve të shteteve tjera. Ministria e Dialogut, Edita Tahiri, e cila ka përfaqësuar Republikën e Kosovës në atë takim, ka cituar dispozitën e Marrëveshjes që ka të bëjë me barazinë e shfaqjes së simboleve. Si rezultat i kësaj, flamuri i Kosovës mbeti i shfaqur.

KOSTT-i është ballafaquar me pengesa në krijimin e marrëdhënieve operacionale me ENTSO-E, për shkak të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të Serbisë. Falë marrëveshjes së 25 gushtit 2015 mbi energjinë dhe kontributin e BE-së, pengesat janë hequr dhe KOSTT-i ka nënshkruar marrëveshjen për kyçje me ENTSO-E.

Kuvendi i Republikës së Kosovës edhe pas dy viteve ende vazhdon të përballet me pengesa në marrjen e statusit anëtar me të drejta të barabarta si anëtarët tjerë në Rrjetin Parlamentar të Vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke mbetur me statusin e vëzhguesit. Këto pengesa janë duke u bërë nga Serbia dhe Bosnja/Republika Srpska në kundërshtim me Marrëveshjen për Bashkëpunim Rajonal të Brukselit, veçanërisht me pikat 1, 2, 4, 8, 9, 10 të Marrëveshjes.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë e Republikës së Kosovës për më shumë se dy vjet vazhdon të ketë pengesa në lidhje me përfaqësimin e tyre në Asociacionin e Rregullatorëve Rajonal të Energjisë ku ZRRE-ja është ende duke u përfaqësuar nga UNMIK-u, në vend të Kosovës siç është rënë dakord, dhe në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të pikave 2, 3, 4 dhe 6 të Marrëveshjes.

Zbatimi i Marrëveshjes duhet të avancon më tej, sepse ajo do t'i mundësojë Kosovës pjesëmarrje dhe anëtarësim në organizata të rëndësishme rajonale, në shkëmbimin e praktikave dhe përvojave në fushën e ekonomisë, atë sociale, kulturore, si dhe në fusha tjera. Gjithashtu kontribuon në ndërtimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, stabilitetin në rajon dhe në rrugën drejt integritit Evropian, ku shteti i Kosovës vazhdon të jetë i përkushtuar dhe i angazhuar në lidhje me këtë marrëveshje.

Përmirësime mund të bëhen përmes rritjes së angazhimit nga BE-ja si ndërmjetësues në këtë proces për të bërë presion ndaj Serbisë për respektimin e Marrëveshjes. Në mënyrë të ngjashme, është i nevojshëm angazhimi i lidershit të organizatave rajonale për respektimin e marrëveshjeve.

Është shënuar progres i rëndësishëm në punën e dy zyrave ndërlidhëse (ZN), veçanërisht në adresimin e kërkesave për vizita zyrtare, si dhe në kryerjen e çështjeve të ndryshme që lidhen me punën e përditshme. Megjithatë, ende disa nga aspektet thelbësore të funksionimit të Zyrave Ndërlidhëse nuk janë zgjidhur, siç janë: mos-zhvillimi i takimeve mes ZN-së së Kosovës me ministrat dhe kryeministrin e Serbisë edhe pas dy viteve të funksionimit, ndërsa ZN-ja Serb u takuan me disa ministra të Kosovës; çështja e vulave, logove janë ende në pritje, etj. ZN-ja e Kosovës në Beograd ka administruar më shumë se 100 vizita zyrtare që nga arritja e marrëveshjes.

Komunikimi ndërmjet Zyrës Ndërlidhëse të Republikës të Kosovës dhe institucioneve Serbë duket të jetë përmirësuar kohëve të fundit, por që në masë të madhe varet nga gatishmëria e zyrtarëve individual pasi që nuk është mbajtur asnjë mbledhje ministrorë, e cila sugjeron mungesën e vullnetit të Qeverisë së Serbisë për të zbatuar këtë aspekt të marrëveshjes. Përveç kësaj, të dy ZN-të kanë diskutuar me përfaqësuesit e BE-së për mundësinë e mbajtjes së takimeve me kryeministrat përkatës të dy shteteve, por ende nuk ka rezultate në këtë çështje. Përkundër faktit që Kosova ka treguar gatishmëri, pala tjetër nuk është përgjigjur. Kemi konsideruar se këto janë takime shumë të rëndësishme, sepse nga ky veprim një mesazh i rëndësishëm do të dërgohet në të gjitha institucionet e tjera që duhet të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë më shumë me të dy ZN-të.

Nuk ka ende zgjidhje për logot dhe vulat zyrtarë. Në mungesë të logove dhe vulave reciproke, veçanërisht Qeveria e Serbisë është shumë e rezervuar që të marrë pjesë në komunikime zyrtare me ZN e Kosovës, përveç shkëmbimit të e-mailave në kërkesat për vizita zyrtare.

Përkundër faktit se të dyja shtetet, në takimin e fundit në nëntor 2014, ranë dakord për të rritur numrin e personelit në ZN-të përkatëse, kjo ende nuk është zbatuar për shkak të hapësirës së kufizuar të ambienteve aktuale të përdorura nga të dy ZN-të, të vendosura në kuadër të zyrave të delegacionit të BE-së.

Rastet e shkeljes së marrëveshjes nga ana e Serbisë

Zbatimi i marrëveshjes është dëmtuar seriozisht nga ana e Serbisë më 14 gusht 2015, kur pavarësisht nga fakti se Qeveria e Kosovës ka refuzuar kërkesën e z. Marko Gjuriq (drejtor për Kosovën në Qeverinë e Serbisë), për të hyrë në Kosovë, ai hyri pa leje. Ky

ishite rasti më i dukshëm, por jo i vetmi. Meqë u arrit marrëveshja për rregullimin e vizitave zyrtare më 14 nëntor 2014, janë vërejtur edhe raste të tjera të ngjashme, duke përfshirë Ministrin e Punës, Punësimin, Veteranëve dhe Politikës Sociale të Serbisë, Aleksandar Vulin i cili gjithashtu ka hyrë në Kosovë pa leje, të paktën dy herë. Në rastin e dytë, më 6 maj 2015, ai jo vetëm që hyri pa leje dhe shkoi në komunën e Dragashit, por gjithashtu inauguroi atje zyrën ilegale paralele të punësimin të Serbisë.

Qeveria e Kosovës konsideron se shkelja më ekstreme e kësaj marrëveshjeje ka ndodhur nga deklaratat e papërshtatshme të zyrtarëve të Serbisë, më 16 prill 2015 që kanë deklaruar se Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës z. Hashim Thaçi do të arrestohet nëse do të hyjë në Serbi për të marrë pjesë në konferencën rajonale për pajtim në Beograd, të organizuar nga Komiteti i Edukimit të Rinjve në Beograd. Kjo ishte përgjigje shumë e paskrupullt nga ana e Serbisë në kërkesën tonë për një vizitë zyrtare. Katër ditë më vonë më 20 prill 2015 Zyrtari Ndërlidhës i Kosovës në Serbi, z. Valdet Sadiku është kërcënuar publikisht nga e ashtuquajtura Lëvizja Rinore Popullore Serbe - 1389 në Serbi; kërcënimi me vdekje u publikua në faqen e tyre në Facebook.

13. MBLEDHJA E TË HYRAVE DOGANORE

Ka pasur progres te theksuar në zbatimin e marrëveshjes për Mbledhjen e të Hyrave Doganore në pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak, në pajtueshmëri me ligjin e Kosovës. Kjo marrëveshje është përforcuar më tej me marrëveshjen e arritur për Licencimin e mallrave të kontrolluara për kompanitë që operojnë në veri të Kosovës, që ka hyrë në fuqi më 7 prill 2015. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje kërkon koordinim me të gjitha agjencitë që lëshojnë licenca dhe me kompanitë që kanë nevojë për shërbim të tillë, përderisa Dogana e Kosovës i ka miratuar masat e kërkuara. Rezultatet e zbatimit janë si në vijim:

Licencimi i mallrave të kontrolluara për kompanitë që veprojnë në veri të Kosovës

Më 7 prill 2015, Doganat e Kosovës në përputhje me marrëveshjen zbatuan planin e rishikuar funksional të Doganave të Kosovës për mbledhjen e të hyrave doganore në PKK-të Jarinjë dhe Bërnjak. Deri më tani nuk ka pasur probleme apo pengesa të raportuara. Të gjitha informatat e përpunimit shkojnë direkt nga sistemi ASYCUDA në Zyrën e Administratës Tatimore për informata.

Në sistemin e Doganave të Kosovës, tashmë janë 439 kompani të regjistruara për eksport dhe import të mallrave nga katër komunat veriore dhe, të gjitha dokumentet e paraqitura nga ato kompani tek Dogana e Kosovës janë në përputhje me ligjin e Kosovës. Nga 439 kompani, gati 200 prej tyre janë kompani aktive në import/eksport. Rreth 98% e këtyre kompanive po ashtu ishin të pajisura me numra fiskal të Kosovës.

Sa i përket licencave, deri më tani ka pasur 195 licenca/leje dhe autorizime të lëshuara nga Agjencitë e Kosovës në lidhje me procedurat për eksport/import për këto kompani në pjesën veriore të Kosovës (185 janë nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës, 7 nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe 1 nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë).

14. CERTIFIKATAT E PRODUKTEVE FARMACEUTIKE (CPF)

Marrëveshja mbi CPF (certifikatat e produkteve farmaceutike), u arrit në parim më 21 maj 2015 gjatë dialogut në Bruksel, ndërsa konfirmimi i pranimit është bërë më 27 qershor 2015. Marrëveshja parasheh njohjen reciproke të Certifikatave për Produkte Farmaceutike mes dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, e cila ndihmon normalizimin e tregtisë në fushën e produkteve medicinale në mes të dy vendeve.

Marrëveshja për CPF-në do të thotë që produktet farmaceutike të prodhuara në Serbi që qarkullonin në Kosovë, pa procedurat e regjistrimit nga tani e tutje do t'i nënshtrohen kësaj procedure dhe do të vendosen në tregun e Kosovës, në përputhje me legjislacionin tonë në fuqi. Gjithashtu, prodhuesit nga Kosova do të jenë në gjendje të vendosin produktet e tyre në tregun e Serbisë, nëpërmjet procedurave përkatëse, në përputhje me ligjin e tyre. Si rezultat i njohjes reciproke të CPF-së çdo produkt mjekësor për të cilin është aplikuar do të regjistrohet në shtetin tjetër.

Marrëveshja për CPF në mënyrë specifike ka adresuar dhe përcaktuar procesin e licencimit në fushën farmaceutike, e cila përfshin:

1. Licencimin e institucioneve (barnatoreve me pakicë, tregtarëve me shumicë dhe prodhuesve)
2. Licencimin e produkteve medicinale
3. Importin e barnave në Kosovë
4. Importin e donacioneve në Kosovë

Sa i përket pikës 1, ka pasur progres deri në një pikë, edhe pse kohëve të fundit ky proces është ngadalësuar dhe nuk ka përfunduar siç pritej. Jo të gjitha farmacitë kanë aplikuar për licencim dhe ato që nuk kanë pasur licenca mund të jenë në rrezik për t'u mbyllur nga inspektorati farmaceutik!!!

Zgjidhja për pikën 1: inkurajimi i farmacive të mbetura për të përfunduar këtë proces.

Tabela më poshtë paraqet farmacitë e licencuara dhe tregtarët me shumicë në katër komunat veriore të Kosovës. Këto institucione kanë aplikuar në kohën e negociatave ku ka pasur disa përpjekje për t'i bindur ato për fillimin e procesit të licencimit me Agjencinë Kosovare për Produkte Mjekësore.

Tregtarët me shumicë	Vendi	Vlefshmëria e licencës
FarmalogistConect	Zveçan	2020
PM-Pharm Plus	Zveçan	2020
VeledragorijaPantaRei	Mitrovica	2020
NG International 2014 - 1	Leposaviq	2020
Farmacitë me pakicë	Vendi	Vlefshmëria e licencës
MoćPriode 1	Mitrovica	2019
MoćPriode	Zveçan	2019
Në procedurën e fundit	Vendi	Vlefshmëria e licencës
Tilia	Leposaviq	2020

Sa i përket pikës 2, nuk është shënuar aspak progres. Ende nuk kemi marrë asnjë aplikacion për regjistrimin e barnave që janë prodhuar në Serbi për shkak të mungesës së CPF-së. Çështja e CPF-së ishte pjesë e marrëveshjes dhe Agjencia në Serbi ende nuk ka nxjerrë CPF-të edhe pse ne kemi informacion zyrtar se disa prej tyre kanë aplikuar në qershor në Agjencinë Medicinale në Beograd dhe ende nuk kanë marrë përgjigje pozitive. Shënim: nëse këta katër tregtarë me shumicë aplikojnë për regjistrim me CPF për këto produkte, atëherë ata mund të realizojnë importin.

Zgjidhja për pikën 2: inkurajimi i Agjencisë në Serbi që të lëshojë CPF-të në mënyrë që tregtarët me shumicë apo përfaqësuesit e prodhuesve në Serbi të bëjnë regjistrimin e këtyre barnave.

Sa i përket pikës 3, **nuk është shënuar aspak progres**. Kjo lidhet me pikën 2. Importi nuk mund të bëhet pa regjistrim, i cili nuk mund të bëhet pa CPF.

Zgjidhja për pikën 3: nëse do të realizohet pika 2 atëherë kompanitë do të bëjnë regjistrimin, kurse importi do të jetë vetëm një reagim i automatizuar i bizneseve.

Sa i përket pikës 4 **është shënuar progres** pasi që procesi është duke shkuar mirë. Kanë ekzistuar disa çështje në disa nga aplikacionet për donacion por janë zgjidhur në minutën e fundit. Sa për përkujtim në lidhje me këtë pikë, aplikimi duhet të bëhet në Ministrinë e Shëndetësisë të paktën 10 - 14 ditë para se të realizohet donacioni pasi që mund të marrë kohë vlerësimi i donacionit në komisionin e Ministrisë. Pasi komisioni të përfundon vlerësimin, AKPM-ja do të lëshon leje të importit.

Zgjidhja për pikën 4: aplikimi paraprak prej 2 javësh për donacion tek Ministria e Shëndetësisë me dokumentet e nevojshme.

15. FONDI PËR ZHVILLIM

Fondi për Zhvillim është rritur vazhdimisht. Në këtë periudhë raportuese janë afërsisht 7.2 milionë euro të mbledhura në llogari të Fondit për Zhvillim, në përputhje me Marrëveshjen mbi mbledhjen e të hyrave në PKK në Jarinjë dhe Bërnjak, e cila thotë se taksat e mbledhura në dy PKK-të nga kompanitë që operojnë në komunat veriore dhe për mallrat e caktuara për qytetarëve e atyshëm, do të ndahen në Fondin për Zhvillim për komunat veriore.

Procesi i shpërndarjes së fondeve ka filluar. Bordi Menaxhues i Fondit për Zhvillim në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2015, vendosi të financojë 1.5 milionë euro për tre projektet e paraqitura nga Komuna e Mitrovicës së Veriut që synojnë të mbështesin zhvillimin socio-ekonomik të komunës. Fondet do të përdoren për ndërtimin e qendrës së zjarrfikësve, mbështetjen për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), si edhe shpronësimin e tokës për ndërtimin e një ndërtese të re të komunës. Procesi i shpërndarjes do të vazhdojë sipas projekteve të paraqitura nga ato komuna.

Sa i përket Lirisë së Lëvizjes, në përgjithësi zbatimi ka qenë i kënaqshëm gjatë periudhës raportuese. Hapja e dy pikave të reja të kalimit kufitar siç u kërkua nga delegacioni i Kosovës, ka ndihmuar përmirësimin e lirisë së lëvizjes dhe nuk kemi marrë asnjë ankesë për këtë çështje. Ngjashëm, funksionimi i mirë ka vazhduar edhe në të gjitha gjashtë PKK-të e tjera.

Disa çështje ende mbeten për t'u trajtuar në një mënyrë më të përshpejtuar, në mënyrë që të lehtësohet një liri kuptimplotë e lëvizjes për qytetarët e të dy vendeve dhe të mundësohet zbatimi i marrëveshjes për LL. Këto çështje përfshijnë: (I) Largimin e masave të përkohshme të aplikuara në mënyrë të njëanshme nga Serbia ("tabelat Proba" për targa RKS, dokumentet e hyrje-daljeve dhe tarifatat për qytetarët e Kosovës), e cila ka qenë barrë dhe frustrim i qytetarëve të Kosovës dhe, (II) praktikatat negative të rasteve nga ana e Serbisë për të bllokuar lirinë e lëvizjes për qëllime politike.

Çështjet e mëposhtme janë ngritur vazhdimisht nga delegacioni jonë dhe kanë qenë të lidhura me marrëveshjet tjera, por pasi që asnjë takim nuk është mbajtur në pothuajse dy vite, ishte e pamundur që këto çështje të zgjidhen.

I. Heqja e masave të përkohshme - tabelat "Prova", dokumenti për hyrje-dalje dhe tarifatat

1. Çështja e mospranimit të tabelave të regjistrimit të automjeteve RKS dhe kërkesat për t'i ndërruar ato me tabelat PROBA për të hyrë në Serbi - Kjo praktikë ka qenë një pengesë e vazhdueshme për lirinë e lëvizjes që nga hyrja në fuqi e marrëveshjes. Kjo është veçanërisht problematike gjatë kulmit të sezonit kur diaspora jonë në mënyrë masive viziton Kosovën. Kërkesa për të hequr tabelat RKS dhe për t'i ndryshuar ato me Proba i merr kohë çdo shoferi rreth 30 min që t'i nënshtrohet procedurës së bashku me dokumentacionin. Përveç kësaj, ky ushtrim kërkon pagesën monetare në mënyrë që të prokurohen tabelat Proba.

Për më tepër, pasi që është arritur marrëveshja për pranimin e ndërsjellë të dokumenteve të sigurimit të automjeteve në mes të dy shteteve këtë vit dhe njohjen e dokumenteve të Republikës së Kosovës për lirinë e lëvizjes që nga viti 2011, mosnjohja e tabelave RKS nuk ka kuptim. Përveç kësaj, çdo tabelë Proba ka një rimbursim monetar për përdorimin e tij, prandaj shkel MM-në për pranimin e ndërsjellë të sigurimit të automjeteve.

Pra, kjo praktikë krijon barrë të panevojshme për shoferët e Kosovës që kanë tabela RKS, po ashtu krijon radhë të gjata në kufi, kësaj duke rritur potencialin për ryshfete dhe korrupsion (një praktikë vazhdimisht e raportuar nga pjesëtarët e Diasporës), dhe shkel thelbin e MM-së për njohje të ndërsjellë.

Së fundmi është qëndrimi ynë i vendosur që aplikimi i tabelave PROBA duhet të largohet nga Serbia.

Përndryshe, ne rezervojmë të drejtën sipas marrëveshjes në LL që të aplikojmë masa reciproke, gjë të cilën do të bëjmë në mungesë të kuptueshmërisë. Pozicioni i Kosovës është në përputhje me Marrëveshjen dhe me konkluzionet përfundimtare funksionale të 29 nëntorit 2011 mbi zbatimin e lirisë së lëvizjes, e cila në pikën 16 përcakton se: **“Pala kosovare ka të drejtë që, pas konsultimeve me BE-në, të zbatojë një regjim të përkohshëm të tabelave të automjeteve serbe.”**

Kosova konsideron se periudha e masave të përkohshme ka përfunduar. Katër vite kanë qenë të mjaftueshme duke pasur parasysh se marrëveshja për LL-në është arritur më 2 korrik 2011. Përveç kësaj, shumë marrëveshje tjera ndërmjet dy palëve që janë duke u zbatuar ose në rrugën e tyre për zbatim, ndihmuan në avancimin e qëllimit të normalizimit të marrëdhënieve fqinjësore mes dy shteteve. Prandaj, Serbia duhet të njohë tabelat RKS të Kosovës, ose të përgatitët për reciprocitet.

2. Dokumenti i Hyrje-Daljeve vazhdon të praktikohet nga ana e Serbisë dhe çdo person që hyn në territorin serb, i nevojitet të marrë një dokument të tillë, duke përfshirë këtu edhe të miturit. Kjo praktikë është zbatuar që nga fillimi i zbatimit të marrëveshjes me arsyen e vetme për të mos pranuar dhe njohur letërnjoftimet e Republikës së Kosovës. Pasi që ishte fillimi, ne kemi qenë të kuptueshëm për këtë praktikë, por me kalimin e kohës janë arritur marrëveshje të tjera - ku pranimi i juridiksioneve ligjore të njëri tjetrit është bërë realitet, dokumenti nuk përbën asnjë masë sigurimi, dhe vazhdon të jetë barra e lirisë së lëvizjes duke konsumuar kohën në mënyrë të panevojshme.

Pala serbe duhet të heqë zbatimin e një dokumenti të tillë menjëherë.

Përndryshe, ne do të ia kthejmë me reciprocitet në praktikë - siç bëjmë në fillim të marrëveshjes.

3. Tabelat e paligjshme të regjistrimit të automjeteve të ish-Jugosllavisë - Serbia vazhdon të lëshojë tabela të automjeteve të ish-Jugosllavisë për territorin e Kosovës (KM, GL, PR etj). Edhe pse ky akt është në kundërshtim me të gjitha marrëveshjet përkatëse dhe në kundërshtim me rregullat e CoB, kjo praktikë ende vazhdohet. Përdorimi i targave ilegale, shumica e të cilave janë të paregjistruara dhe të pasiguruara krijon një barrë financiare për Bankën Qendrore të Kosovës si garantues i sigurimit dhe industrisë së

sigurimeve në Kosovë, për të cilat Qeveria ka marrë disa letra ankuese nga Zyra e Sigurimeve të Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë disa hapa për të lehtësuar një tranzicion të lehtë për tabelat e ligjshme (KS ose RKS) duke i siguruar fleksibilitet në procesin e duhur; fleksibilitet të tillë si koha, kalimi i lirë në targa ligjore, pranimi i një pagese doganore (e cila ishte supozuar që tashmë të bëhet në Serbi) etj. Një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të etnive të ndryshme të Kosovës, por kryesisht serbët kanë zëvendësuar tabelat e paligjshme të regjistrimit të automjeteve me ato të ligjshme. Megjithatë, shumica e banorëve të katër komunave veriore kanë vazhduar të përdorin tabelat ilegale.

Pala serbe duhet të ndalojë lëshimin e targave të tilla për territorin e komunave të Republikës së Kosovës. Në qoftë se ndërmerret një masë e tillë me vendosmëri të lartë nga ana e BE-së, pozicioni i jone do të jetë i tillë që ne nuk do të ndërmarrim asnjë hap por do të presim për një fazë graduale të largimit të tabelave ilegale.

Nga ana tjetër, ne duhet të ndërmarrin masa në mënyrë që të heqim tabelat ilegale nga rrugët e RKS.

II. Çështja e bllokimit të lirisë së lëvizjes për qëllime politike nga ana e Serbisë - rasti i zgjedhjeve lokale në Medvegjë

Gjatë periudhës së fundit kemi vërejtur me shqetësim fenomenin e bllokimit të lirisë së lëvizjes për qëllime politike nga ana e Serbisë, në rast të PKK-së së Mutivodës në ditën e zgjedhjeve lokale në Medvegjë (më 13 shtator 2015). Serbia e ka shkelur Marrëveshjen për LL duke mbyllur disa herë PKK-në Mutivoda apo duke ngadalësuar procesin e kontrollit kufitar në mënyrë që të parandalojë votuesit e komunës së Medvegjës të cilët po udhëtonin nga Kosova për në Medvegjë për të ushtruar të drejtën e tyre demokratike për votim. Ky problem u zgjidh kryesisht në sajë të ministres së dialogut Edita Tahiri dhe ekipit të saj, ZN-së Valdet Sadiku dhe lehtësuesit të BE-së Alexis Hupin të cilët kanë qenë gjithë ditën në komunikim interaktiv për të hequr pengesat e Serbisë, në mënyrë që votuesit të mund të kalojnë kufirin. Duam të theksojmë se BE-ja duhet të jetë më e vendosur kur i kërkon Serbisë të ndalë shkeljen e marrëveshjeve të Brukselit dhe standardeve të BE-së.

Të gjitha pengesat janë paraqitur në letrën e Ministres Tahiri të drejtuar BE-së/Alexis Hupin në të njëjtën ditë me 13 shtator 2015: Që nga mëngjesi jemi duke punuar me ju, BE-në dhe EULEX-in, duke u përpjekur që të heqim barrierat e Serbisë ndaj marrëveshjes për Liri të Lëvizjes në PKK Mutivodë. Lloje të ndryshme të pengesave janë përdorur nga

Serbia për të parandaluar shqiptarët e Luginës së Preshevës, në veçanti të komunës së Medvegjës që të shkojnë nga Kosova në Serbi me qëllim të votimit në zgjedhjet e sotme lokale në Medvegjë. Duke punuar së bashku me ju dhe falë ndërhyrjes suaj me Serbinë ne mundëm që të zhbllokojmë situatën apo të shpejtojmë këtë proces, megjithatë ka pasur dhe ende ka shumë njerëz në pritje për të kaluar kufirin, dhe tensionet ishin të pranishme gjatë gjithë ditës. Serbia në mënyrë të qartë nuk do të lejojë shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe në veçanti të komunës së Medvegjës të cilët jetojnë në Kosovë (në mungesë të perspektivës atje) të shkojnë atje për të votuar.

Në këtë moment duke ju shkruar juve (dhe dërgimit të sms-it disa minuta më parë), Serbia prapë është duke ngadalësuar procedurat në PKK Mutivodë, që tregon qartë se shumë shqiptarë nuk do të jenë në gjendje të arrijnë tek qendrat e votimit për të votuar. Udhëheqësit politikë shqiptarë bënë të ditur se në qoftë se kjo nuk do të rregullohet, ata do të ndalin procesin e votimit. Për informacionin tuaj, kjo situatë ishte e parashikueshme, sepse vetë kryeministri i Serbisë Vuçiq bëri të ditura qëllimet e tij për këtë lloj të lojës politike dhe diskriminimit politik kundër shqiptarëve të Medvegjës, ndër të tjera ai tha: Le të shohim kush do të fitojë në Medvegjë, Thaçi, Rama apo unë. (shih linkun: <http://www.balkanweb.com/site/vucic-ironizon-kush-do-te-fitoje-ne-medvegjen-me-7-shqiptare-rama-apo-thaci/>). Sa për informimin tuaj, Serbia arriti të spastrojë etnikisht Medvegjën gjatë viteve të fundit, ky qytet i cili ishte deri kohëve të fundit kishte numër të madh të shqiptarëve, ka mbetur pothuajse bosh, sepse ata kanë ikur në Kosovë për shkak të diskriminimit dhe mungesës së perspektivës. Lidhur me politikën diskriminuese po përmend edhe dështimin e Serbisë për të zbatuar marrëveshjen për njohjen reciproke të diplomave, e cila do të jetë mjaft e dobishme për shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe do t'i bëjë ata të qëndrojnë në trojet e tyre etnike në vend se të ikin ashtu si ka ndodhur. Shpresoj se ju/BE-ja mund të bëni diçka më shumë sot, ora është 5:20 pasdite dhe pikat e votimit mbyllet në ora 7. Duhet të merren masa për t'u siguruar që ata të cilët kanë të drejtë do të mund të votojnë sot. Përndryshe procesi zgjedhor mund të dështojë, tha ministrja Tahiri në letrën e saj.

17. TREGTIA E LIRË

Marrëveshja, në përgjithësi, është zbatuar mirë. Sidoqoftë, shqetësimi kryesor mbetet shfrytëzimi paralel i vulave të doganave nga pala serbe, për të cilën Kosova rregullisht i ka raportuar BE-së dhe çështja është diskutuar edhe në takimet e Brukselit.

Serbia është duke shkel marrëveshjen përmes përdorimit të vulave paralele në dogana
Në pajtim me konkluzionin e arritura në Bruksel më 16 shtator 2014, është kërkuar që praktika e vulave paralele të përmbillet brenda muajit. Deri më tani asgjë nuk ka

ndryshuar, dhe dogana serbe vazhdon ende të përdorë vulat e tilla ilegale. Bazuar në raportet ditore nga PKK Merdare dhe PKK Dheu i Bardhë, malli që vjen tek këto PKK, në dokumentet doganore për mallrat që kanë për destinacion Kosovën, autoritetet doganore serbe ende vazhdojnë që të vendosin vulat e institucioneve paralele me mbishkrimet e të ashtuquajturave “carinaranica pristina i kosovska mitrovica” (Dogana e Prishtinës dhe Mitrovicës së Kosovës). Përveç kësaj, në diagramin administrativ të doganave të Serbisë ende përfshihet Prishtina si zyrë doganore. (shihni iu lutem: www.carina.rs/lat/ONama/organizacija/Stranice/Osnovna.aspx)

Ka nevojë që të arrihet pajtimi edhe për çështjen e njohjes reciproke të certifikatave për ngarkesa ndërkombëtare të mallrave të rrezikshme përmes rrugës tokësore (ADR).

Mungesa e njohjes reciproke të certifikatave të ADR-së ka paraqitur pengesa për tregtinë e lirë të mallrave që janë në kuadër të kategorizimit ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme.

Më 27 gusht 2015 inspektorët nga Ministria e infrastrukturës së Serbisë në autostradën Nish-Beograd kanë ndaluar dy kamionë me tabela regjistrimi nga Kosova që transportonin gaz nga Serbia në Kosovë. Ata kërkuan nga kjo kompani që të ketë certifikatën ndërkombëtare për bartjen e mallrave të rrezikshme përmes rrugës tokësore (ADR)^[1] të lëshuar nga autoritetet e Serbisë ashtu që të mund të lëvizin lirshëm në territorin e Serbisë pasi që ata nuk e pranonin certifikatën e ADR-së të lëshuar në Kosovë. Ky rast ka ndodhur për herë të parë.

Pas përfshirjes tri-javore të zyrës së Ministres për Dialog, Brukselit, EULEX-it dhe Zyrtarit tonë Ndërlidhës në Serbi, më në fund mallrat janë liruar por zgjidhja nuk është e qëndrueshme në aspektin afatgjatë. Për këtë arsye, ne si Qeveri e Kosovës kemi kërkuar nga Brukseli që të iniciojë një grup punues i cili do të adresonte çështjen e njohjes reciproke të kësaj certifikate, e gjithashtu edhe të certifikatave tjera për transport.

18. TË DHËNAT KADASTRALE

Marrëveshja e Brukselit për të dhënat kadastrale e arritur më 2 shtator 2011 kërkon që të kthehen në Kosovë dokumentet kadastrale të marra nga Serbia gjatë luftës në vitin 1999.

^[1] Shpjegim në lidhje me Certifikatën për bartjen ndërkombëtare të mallrave të rrezikshme (ADR): Lëvizja e mallrave të rrezikshme përmes rrugës tokësore rregullohet me rregullore ndërkombëtare dhe ka politikë të rreptë. Shumica e vendeve evropiane kanë nënshkruar Marrëveshjen evropiane për bartjen ndërkombëtare të mallrave të rrezikshme përmes rrugës tokësore (ADR).

Është arritur pajtim edhe rreth Konkluzionit Operativ të arritur në Bruksel më 21 tetor 2011. Marrëveshja kërkon nga pala kosovare miratimin e ligjit për Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) dhe themelimin e saj. Paralelisht, kërkohet nga pala serbe që të bëjë skanimin e dokumenteve kadastrale që do të kthehen në Kosovë përmes përfaqësuesit special të PSBE-së.

Zbatimi i marrëveshjes ka mbetur pezull

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje ende nuk ka filluar.

Pala kosovare ende nuk e ka miratuar ligjin për agjencinë e re teknike- Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) – edhe pse ka kaluar për herë të dytë leximin e parë në Kuvendin e Kosovës më 27 prill 2015. Nga ana tjetër, pala serbe pjesërisht ka kryer procesin e skanimit. Gjykata Kushtetuese e Serbisë ka anuluar Marrëveshjen por ngërçi është tejkaluar përmes dekretit të qeverisë së tyre dhe pastaj është vazhduar me skanim.

Pala kosovare ka përshpejtuar miratimin e Ligjit për agjencinë teknike AKKVP nga ana e Kuvendit të Kosovës. Arsyeja pse Kuvendi refuzon miratimin e këtij ligji është për shkak të pranisë ndërkombëtare në agjencinë e re teknike duke pasur parasysh që Kosova ka kaluar periudhën e mbikëqyrjes së mbikëqyrur, prandaj, roli i ndërkombëtarëve në institucionet kosovare ka marrë fund. Kjo pengesë është tejkaluar pas këmbimit të letrave mes Presidentes së Kosovës dhe përfaqësueses së BE-së Kethrin Eshton që është miratuar nga Kuvendi i Kosovës si Marrëveshje ndërkombëtare. Konsiderojmë që është dhënë mbështetje e mjaftueshme politike nga deputetët dhe komisionet përkatëse në dobi të miratimit. Ministria për dialog, Edita Tahiri gjithashtu ka marrë pjesë në seancën dëgjimore para Komisionit për legjislacion në Kuvendin e Kosovës më 1 korrik 2015. Ajo argumentoi rëndësinë e miratimit të këtij projekt ligji nga Kuvendi i Kosovës.

Pas miratimit të këtij ligji, ne gjithashtu do të themelojmë këtë agjenci teknike në mënyrë të përshpejtuar.

Pala serbe gjithashtu ka përshpejtuar procesin e skanimit duke pasur parasysh se shumë pune duhet bërë gjatë këtij procesi. Delegacioni i BE-së në Serbi është duke financuar projektin e skanimit të dokumenteve kadastrale.

Deri më tani janë skanuar 2,556,934 imazhe nga 190 libra të skanuar. Numri i parashikuar i imazheve që duhet kryer është 4,037,264 nga gjithsej 300 libra. Gjatë kësaj periudhe ka filluar edhe para-pilot indeksimi i të gjitha dokumenteve të skanuara. Që nga fillimi i

marsit e deri më tani janë indeksuar 78,663 imazhe ndërsa nga 8 maji deri më 22 korrik 2015 janë indeksuar edhe 40,722 imazhe.

BE-ja do ta ketë rolin e agjencisë teknike, në pajtim me marrëveshjen dhe me planin e zbatimit.

Ligji i Kosovës për agjencinë teknike, përmban këto elemente kryesore:

Bordi teknik i Agjencisë do të përbëhet nga pesë (5) anëtarë. Emërtimi i anëtarëve të Bordit bëhet në pajtim me ligjin e Kosovës nr. 04/L-274 për shkëmbimin e letrave mes PL së BE-së Eshton dhe Presidentes së Kosovës si dhe në projekt ligj është vendosur në nenin 6. Dy anëtarë do të emërtohen nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e Kryeministrit. Tre anëtarë emërtohen nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE). Sekretariati ekzekutiv ka një drejtor dhe një zëvendës drejtor. Drejtori dhe zëvendësi i tij emërtohen nga Kuvendi i Kosovës pas propozimit nga ana e Kryeministrit dhe në projekt propozim është vendosur në nenin 7. Shkalla e parë e mekanizmit të vendosjes është përcaktuar nga Marrëveshja e Brukselit për të dhënat kadastrale si dhe në projekt ligj është përmendur si Komisioni për verifikim dhe vendosje për prona (KVVP) (pika 5 e Marrëveshjes). KVVP përbëhet nga pesë (5) anëtarë. Dy (2) anëtarët e KVVP-së emërtohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas propozimit të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, derisa tre (3) anëtarët tjerë të Komisionit, përfshirë edhe një (1) përfaqësues nga komuniteti jo-shumicë, do të emërohen nga PSBE-ja. Në projekt ligj kjo është vendosur në nenin 9. Shkalla e dytë e mekanizmit të vendosjes gjithashtu është përcaktuar nga Marrëveshja e Brukselit për Kadastrin (pika 6) dhe në projekt ligj është vendosur në nenin 15- E drejta në ankesë. Gjykata Supreme vendos lidhur me ankesat përmes një paneli të përbërë nga tre (3) gjyqtarë. Dy anëtarët emërohen në përputhje me dispozitat e Kuvendit të Kosovës me propozimin e Kryeministrit në përputhje me ligjin nr. 04/L-274 për shkëmbimin e letrave mes PL-së së BE-së dhe Presidentes së Kosovës (2013) dhe një anëtar do të emërohet pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe miratimit nga ana e Presidentes së Kosovës. (pika 8).

19. DIPLOMAT

Kjo marrëveshje ka dështuar tërësisht, sepse Serbia kurrë nuk i ka njohur rreth 400 diploma që janë certifikuar nga Asociacioni Evropian i Universiteteve (EAU), ashtu siç parashihet në Marrëveshje. Përveç kësaj, vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë kundër marrëveshjes për njohjen e diplomave ka komplikuar edhe më tej procesin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Kosova konsideron se refuzimi i Serbisë për t'i njohur diplomat universitare të Kosovës përkon me politikat e saj diskriminuuese kundër komunitetit shqiptar në Luginën e Preshevës. Është e njohur që shumica e studentëve shqiptarë nga ky rajon kanë diplomuar nëpër universitetet e Kosovës.

Dështimi i kësaj marrëveshjeje është ngritur si çështje dhe vazhdimisht është raportuar nga ana jonë tek BE-ja.

Katër vite më pas, më 28 dhe 29 shtator 2015, është diskutuar për ri-jetësimin e këtij problemi dhe palët u pajtuan për një marrëveshje të re për njohjen e dyanshme të diplomave mes dy vendeve. Marrëveshja e re specifikon procedurat e mëtejme, vë në shprehje kriterin e njohjes akademike dhe profesionale dhe përfshinë të gjitha nivelet e shkallëve universitare duke përfshirë edhe diplomat nga shkollat profesionale dhe ato të shkollave të mesme. Kërkohet gjithashtu edhe njohja e diplomave të certifikuara nga EAU që të njihen nga Serbia brenda 5 muajve dhe 14 nga Kosova dhe të vazhdohet me zbatimin sipas dispozitave të dakorduara.

Mbetet të shihet, nëse Serbia do ta ofrojë atë për të cilën është dakorduar, duke marrë parasysh se këtë gjë nuk e ka bërë që katër vjet.

Serbia ka bllokuar tekstet shkollore të Kosovës të dërguara për shqiptarët nga Lugina e Preshevës

Në fushën e arsimit, problemet në bashkëpunimin mes dy shteteve gjithashtu përfshijnë edhe dërgimin e teksteve shkollore për minoritetet në shtetin tjetër. Derisa Kosova është treguar fleksibile në këtë pikëpamje, Serbia ka bllokuar librat e dërguar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) së Kosovës për shqiptarët e Luginës së Preshevës. Tekstet shkollore janë dërguar para një muaji dhe ende nuk lejohen që të shpërndahen dhe janë bllokuar në terminalin doganor në Preshevë, me arsyetimin se duhet zbatuar procedurat e duhura.

Çështja është ngritur edhe në takimin trepalësh në Bruksel më 28 shtator 2015, ku Serbia ka premtuar se do ta jap përgjigjen brenda dy ditësh. Afati veçse ka kaluar por ende nuk ka asnjë përgjigje.

(Fund)

Për më shumë informata në lidhje me këtë proces, marrëveshjet dhe raportet e mëhershme periodike, iu lutem referojuni faqes zyrtare të Qeverisë së Kosovës: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,252>

Lista e shkurtesave

ASYCUDA - Sistemi i Automatizuar për të Dhënat Doganore
PKK- Pikë Kalimi Kufitar
KQZ - Komisioni Qendror Zgjedhor i Kosovës
CEFTA - Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
MC - e ashtuquajtura 'Mbrotjtja Civile'
CPF - Certifikata e Produktit Farmaceutik
LRC - Libri i Regjistrimit Civil
DRC - Këshilli Danez për Refugjatë
EEAS - Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm
DHD - Dokumenti për Hyrje-Dalje
EMS - Sistemi Serb i Transmisionit dhe Operatori i Tregut
ENTSO - Rrjeti evropian i operatorëve të sistemit të transmetimit për energji elektrike
ZRRE- Zyra e rregullatorit të energjisë së Kosovës
BE - Bashkimi Evropian
EUA - Asociacioni Evropian i Universiteteve
EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
PSBE - Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
FBK - Federata e Basketbollit të Kosovës
FIBA - Federata Ndërkombëtare e basketbollit
QRK - Qeveria e Republikës së Kosovës
PL - Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri
IBM - Menaxhimi i Integruar i Kufirit(MIK)
GZ -Grupi Implementues
IPA - Instrumenti i BE-së për asistencën e para-anëtarësimit
KEDS - Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike
KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KOSTT - Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu i Kosovës
PK - Policia e Kosovës
KPK - Këshilli Prokurorial i Kosovës
AKKVP - Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës
ZN - Zyrtari ndërlidhës
MARRI - Iniciativa rajonale për migrim, azil dhe refugjatë
MMPH - Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor
NLR - Ndihma ligjore reciproke
MAPL - Ministria e administrimit të pushtetit lokal

ZAMV - Zyra administrative e Mitrovicës veriore
MM - Memorandum mirëkuptimi
OSBE - Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë
KM - Kryeministri
ARKEP - Autoriteti rregullativ i komunikimeve elektronike dhe postare në Kosovë
SEED - Sistemi për shkëmbimin e të dhënave të akcizës
SPARK - Organizatë jo-qeveritare holandeze
OST - Operatori i Sistemit të Transmetimit
EUA - Shoqata e universiteteve Evropiane
UNESCO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për arsim, shkencë dhe kulturë
UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNOPS - Zyra e Kombeve të Bashkuara për shërbime projektuese
AKKVP - Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës
ADR- Marrëveshja evropiane për ngarkesat ndërkombëtare të mallrave të rrezikshme
përmes rrugës tokësore
RKS - Republika e Kosovës
TPL - Sigurimi i përgjegjësisë ndaj palës së tretë
MLL- Marrëveshja për lëvizjen e lirë
NV - Ndërmarrje e vogël
APMK - Agjencia për produktet medicinale e Kosovës
KEDS - Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike